



Udhëzues për integrimin e të mësuarit praktik të trashëgimisë kulturore në kurrikulën mësimore





Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut” mundësuar nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor - ReLOaD financuar nga Bashkimi Evropian, me bashkë-financim nga Komuna e Istogut, dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.

Autor: GUIDEKS – Asociacioni i Guidave Turistike të Kosovës

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren & Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr.5,
Prishtinë

www.ecmandryshe.org info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 967

Qershor, 2020

**UDHËZUES PËR
INTEGRIMIN E TË
MËSUARIT PRAKTIK TË
TRASHËGIMISË
KULTURORE NË
KURRIKULËN MËSIMORE**

Përmbajtja

I. Hyrje	6
II. Analizë e gjendjes ekzistuese	8
2.1. Trashëgimia Kulturore në Kurrikulën Mësimore	8
Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (klasa 1-5)	8
Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët të Kosovës (klasa 6-9)	10
Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës (klasa 10-12)	11
2.2. Komuna e Istogut – Profil i sektorit të Arsimit	13
2.3. Komuna e Istogut – Institucionet Kulturore	14
2.4. Trashëgimia Kulturore në nivel qendror – fokusi në fushën e edukimit dhe ngritjes së vetëdijes	15
Korniza institucionale dhe ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore	15
Strategjia Kombëtare e Kosovës për Trashëgimi Kulturore 2017-2027	17
Trashëgimia Kulturore në Komunën e Istogut	17
III. Propozimet	19
1. Doracak për Mësimdhënës: Njësi mësimore për Trashëgiminë Kulturore dhe Diversitetin Kulturor	21
Zbatimi i Doracakut në Shkollat e Komunës së Istogut	22
2. Doracak: Hyrje në Trashëgimi Kulturore – Vetëdijesimi i të Rinjëve për Vlerat e Trashëgimisë Kulturore	23
Zbatimi i Doracakut në Shkollat e Komunës së Istogut	23
3. Përdorimi i filmit në mësimdhënie	25
Përdorimi i filmit në mësimdhënie në Shkollat e Komunës së Istogut	26
Aktivitetet Jashtëkurrikulare	27
4. Muzeu Mobil – Muzeu Kombëtar i Kosovës	28
Muzeu Mobil në Shkollat e Komunës së Istogut	29
5. Vizita dhe ligjerata të profesionistëve të trashëgimisë kulturore në shkolla	30
Vizitat e profesionistëve në shkollat e Komunës së Istogut	31
6. Vizitat studimore	32
6.1. Vizitë në qytetin / fshatin tënd	32
6.2. Vizitë në Muzeun Arkeologjik dhe monumentet në qytetin e Istogut	37

6.3.	Vizitë në Muzeun Etnologjik dhe Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Pejë	39
6.4.	Ekskursionet një ditore brenda territorit të Kosovës.....	41
7.	Ekspozitat (Artet e bukura, fotografia dhe format tjera artistike).....	46
8.	Lojërat – Edukimi përmes argëtimit.....	48
8.1.	Kuizi i Trashëgimisë Kulturore.....	48
8.2.	E ka Kush e Ka.....	49
8.3.	Përjetimi i historisë nëpërmjet dramatizimit në vendet e Trashëgimisë kulturore	51
9.	Aktivizmi dhe pjesëmarrja aktive në aktivitete të lira dhe shoqata ...	53
9.1.	Aktivizmi dhe puna vullnetare në shkollat e Komunës së Istogut.....	54
10.	Festimet në data të veçanta – Shënimi i datave të rëndësishme.....	55
IV.	Konkluzionet dhe Rekomandimet	57
V.	Lista e librave që rekomandohen për lexim	60
	Aneks 1 – Fleta e Aktiviteteve për Nxënësit (UNESCO).....	62
	Aneks 2 – Fleta e Aktiviteteve për Nxënësit (UNESCO).....	63

I. Hyrje

"Trashëgimia kulturore paraqet një grupim të burimeve të trashëguara nga e kaluara i cili sot identifikohet nga njerëzit si reflektim dhe shprehje e vlerave, besimeve, njohurive dhe traditave të tyre. Ajo përfshin të gjitha aspektet e mjedisit që rezultojnë si ndërveprim ndërmjet njerëzve dhe vendeve gjatë kohës"

Konventa Faro, 2005¹

Trashëgimia kulturore bën pjesë në të drejtat për kulturë, të përcaktuar në nenin 27 të Deklaratës Univerzale për të Drejtat e Njeriut.² Në të drejtat kulturore përfshihen të drejtat e njerëzve dhe komuniteteve për të njohur, kuptuar, vizituar, përjetuar, mirëmbajtur dhe shfrytëzuar trashëgiminë kulturore dhe shprehjet kulturore, si dhe të drejtën për të luajtur një rol të barabartë në procesin e identifikimit, ruajtjes dhe transmetimit të vlerave të trashëgimisë kulturore në gjeneratat e ardhshme. Të drejtat tjera kulturore përfshijnë të drejtën për lirinë e shprehjes dhe të drejtën për edukim.

Trashëgimia kulturore e Kosovës është shprehje dhe krijimtari e realiteteve jetësore të zhvilluara në harkun kohor mbi tetë mijë vjet, që nga parahistoria në vijim deri më sot. Kjo pasuri e trashëguar me vlera unike artistike, estetike, historike dhe karakteristika tradicionale, ilustron me diversitetin e pasur të trashëgimisë arkitekturore, arkeologjike, të luajtshme dhe shpirtërore, si dhe me peizazhin e pasur kulturor.³

Një prej sfidave kryesore me të cilët ballafaqohet mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Kosovë është edukimi dhe ndërgjegjësimi qytetar dhe promovimi dhe rritja e dukshmërisë së potencialit të vlerave të kësaj trashëgimie në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ngritja e vetëdijes, edukimi dhe përfshirja e komunitetit dhe qytetarëve në procesin e identifikimit dhe kuptimit të vlerave të pasura të trashëgimisë kulturore paraqet një proces shumë të rëndësishëm por njëkohësisht edhe kompleks.

Me theks të veçantë, investimi në edukim të hershëm paraqet një mjet shumë të fuqishëm për të bërë ndryshime pozitive shoqërore për të ardhmen e një vendi.

¹ Këshilli i Europës, *Convention on the Value of Cultural Heritage for Society* (Konventa mbi Vlerat e Trashëgimisë Kulturore për Komunitetin), <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae695>, qasur Qershor 2020.

² UNESCO, *The right to Culture* (E Drejta për Kulturë), http://www.unesco.org/culture/culture-sector-knowledge-management-tools/10_Info%20Sheet_Right%20to%20Culture.pdf, qasur Qershor 2020.

³ Jerliu Florina, *Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027*, MKRS, Prishtinë, faqe 22.

Udhëzuesi është hartuar në kuadër të projektit “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut”. Qëllimi kryesor i këtij projekti është ngritja e kapaciteteve dhe pjesëmarrjes së të rinjëve në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Istogut, nëpërmjet tregimit dhe metodave praktike të mësimi. Si objektive specifike në kuadër të këtij projekti është përcaktuar zhvillimi i mjeteve praktike nëpërmjet një udhëzuesi i cili do të ofron informata praktike rreth përfshirjes së trasëhgimisë kulturore në programin mësimor.

Ky udhëzues është hartuar për punonjësit në sektorin e arsimit fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, me theks të veçantë për Komunën e Istogut. Udhëzuesi i dedikohet ekipit profesional të angazhuar në Drejtorinë Komunale të Arsimit, për drejtorët dhe udhëheqësit e shkollave, dhe për mësimdhënësit, në veçanti për ata që ligjërojnë lëndët nga fusha shoqëria dhe mjedisi, duke mos anashkaluar edhe mësimdhënësit e gjuhës amtare, artit figurativ dhe artit muzikor.

Ky udhëzues është hartuar për të shërbyer si një mjet praktik për mësimdhënësit, për të përmirësuar vlerën e edukimit, duke nxitur përfshirjen aktive dhe mendimin kritik tek nxënësit.

Udhëzuesi përbëhet prej dy pjesëve kryesore:

Pjesa e parë përmban një analizë të hollësishme të programit të edukimit me fokus në trajtimin e lëndëve ku përfshihet tema e trashëgimisë kulturore. Kapitulli i parë i pjesës së parë, shtjellon programin mësimor për tri cikle të edukimit: fillor, i mesëm i ulët, dhe i mesëm i lartë, hapësirën që i ofrohet trajtimit të temave që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore, dhe objektivat kryesore që duhet të përmbushen.

Më tutje, në kapitullin e dytë paraqitet profili i Komunës së Istogut, me theks të veçantë në fushën e edukimit dhe të kulturës. Numri i shkollave, numri i mësimdhënësve për nxënës, organizimi i kurrikulës bërthamë. Për të vazhduar më tutje me një prezantim të përgjithshëm në lidhje me institucionet kulturore ekzistuese në Komunë.

Në kapitullin e tretë, paraqitet korniza institucionale dhe ligjore në fushën e identifikimit, mbrojtjes, promovimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Pjesa e dytë e udhëzuesit përmban propozimet duke u bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese dhe në shembuj praktik të ilustruar, si nga vendi ashtu edhe me shembuj ndërkombëtar.

Shembuj të ndryshëm në lidhje me mësimin praktik dhe përfshirjen e temave të trashëgimisë kulturore në programin shkollor, paraqiten dhe elaborohen, duke dhënë propozime konkrete se si këto aktivitete mund të aplikohen në shkollat e Komunës së Istogut, dhe jo vetëm.

Në fund udhëzuesi përmbyllet me Konkluzionet dhe Rekomandimet që përfshijnë hapat e më tutjeshëm të cilët duhet të ndërmerren për të filluar zbatimin e këtij udhëzuesi praktik.

II. Analizë e gjendjes ekzistuese

2.1. Trashëgimia Kulturore në Kurrikulën Mësimore

Në vitin 2017, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lansoi kurrikulën e re për të gjitha shkollat në territorin e Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në këtë kurrikulë, qëllimi kryesor i arsimit parauniversitar është mbështetja e nxënësve për të zhvilluar dijet, shkathtësitë dhe vlerat në harmoni me kërkesat e shoqërisë demokratike, duke kultivuar identitetin personal dhe të përkatësisë shtetërore, promovuar vlerat e përgjithshme kulturore, zhvilluar përgjegjësitë ndaj vetes dhe shoqërisë e mjedisit, duke u aftësuar për mësim në kontekste të ndryshme kulturore.

Në kuadër të kësaj kurrikule, tema e fushës së trashëgimisë kulturore trajtohet në fushat: Shoqëria dhe Mjedi, dhe Artet duke përfshirë edhe aktivitetet jashtëkurrikulare, të cilat mund të planifikohen në nivel të shkollës dhe kanë për qëllim në plotësimin e arritjes së kompetencave për shkallë të kurrikulës.

Në vijim do të paraqiten objektivat dhe rezultatet e pritura nga lëndët e kurrikulës ku trajtohet trashëgimia kulturore në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (klasa 1-5)

Fusha: Artet - Lëndët: Edukatë Figurative dhe Edukatë Muzikore

Në kuadër të fushës mësimore Artet, respektivisht Arti figurativ, krahas mësimit të elementeve bazike, në konceptin: Relacioni art – shoqëri, parashihet krijimi i ndërlidhjes ndërmjet njohurive të fituara nga fusha Shoqëria dhe Mjedi, me krijimin e shkathtësive artistike.

Nxënësit e shkollës fillore (Klasat 1-5) parashihet që të arrijnë rezultatet e të nxënës, në mënyrë që të njohin dhe dallojnë objektet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore (kombëtare dhe të kulturave të tjera); -Të njohin disa objekte nga arkitektura dhe arti publik në qendrat botërore dhe të krahasojnë ato duke treguar rëndësinë dhe vlerën që kanë; si dhe të njohohen me institucionet kulturo – artistike në vend (muzetë, galeritë, vende arkeologjike), duke qenë në gjendje të përshkruajnë dhe prezantojnë punën e ekspozuar në institucionin kulturor përkatës.

Fusha: Shoqëria dhe mjedi

Qëllimi i kësaj fushe është që nxënësi të aftësohet për njohjen më të mirë të vetvetes, bashkësisë, shoqërisë dhe mjedisit jetësor në të kaluarën dhe në të tashmen, në funksion të krijimit të qytetarit të përgjegjshëm që njeh dhe zbaton normat dhe rregullat e organizimit shoqëror e demokratik.

Në kuadër të koncepteve të përgjithshme të kësaj fushe, përfshihet edhe Koncepti: Proceset shoqërore dhe natyrore, i cili përfshin: *"...njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet e shoqërisë për vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, bashkëjetesën, solidaritetin, traditat, festat, si dhe njohuritë për proceset shoqërore, që shpjegojnë ndryshimet në jetën e përditshme."*

Kurse në Konceptin: Mjedisit, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm, ndër tjerash, *"përfshin edhe vetëdijesimin dhe angazhimin për nevojën e shfrytëzimit dhe ruajtjes së mjedisit, resurseve dhe biodiversitetit për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, dhe njohuri për trashëgiminë natyrore dhe kulturore dhe kujdesin për to."*

Rezultatet e pritura nga kjo fushë për këtë cikël të arsimit, përmbajnë arritjen e njohurive bazë të nxënësve për:⁴

- Njohjen e rëndësisë së monumenteve, dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore.
- Të kuptuarit e proceseve dhe dukurive të ndryshme shoqërore dhe natyrore dhe ndërvlerësimin e njeriut me natyrën, dhe respekti për trashëgiminë kulturore e natyrore.
- Mësimi i zbatimit të normave dhe rregullave shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet, duke identifikuar dhe respektuar traditat dhe festat si pasqyrim i llojllojshmërisë kulturore, dhe duke dalluar llojllojshmërinë e etnive, kulturave, racave dhe besimeve të ndryshme.
- Pjesëmarrjen në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit dhe përkujdesjen për trashëgiminë kulturore.

Në pjesën ku paraqitet metodologjia e përgjithshme, kurrikula ofron mundësinë e aktiviteteve jashtëkurrikulare që janë aktivitete të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të fushave dhe lëndëve mësimore, por që ndihmojnë arritjen e kompetencave për shkallë të kurrikulës. Këto aktivitete mund të planifikohen në kuadër të shkollës, dhe mund të përfshijnë:

- **Vizita** në muze, parqe, vende historike, institucione publike, institucione kulturore etj;
- **Festimet** në data të veçanta, ngjarje, suksese;
- **Pjesëmarrja** në grupe mësimore, në aktivitete të lira dhe në shoqata;
- **Diskutimet me mysafirët** (d.m.th., me udhëheqësit e bashkësisë, me prindërit, profesionistë të fushave të ndryshme, përfaqësues të institucioneve, me persona dhe grupe të ndryshme që vijnë nga vendet e tjera);
- **Puna me projekte** që fokusohen në tema dhe në çështje specifike të karakterit shumëdimensional që përkujdesen me moshën e nxënësve;
- **Ekspozitat** (d.m.th. artet e bukura, fotografia);
- **Lojërat**, koret dhe puna vullnetare.

⁴ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor (Klasa 1-5)*, faqe 62, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>, qasur Qershor 2020.

Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët të Kosovës (klasa 6-9)

Fusha: Artet - Lëndët: Edukatë Figurative dhe Edukatë Muzikore

Në tekstin hyrës ku shtjellohet tema e kësaj fushe, përkufizimi i Arteve përfshin krijimtarinë artistike autoriale por edhe **elemente të trashëgimisë kulturore** lokale, kombëtare e universale të manifestuar përmes kulturës, artefakteve, objekteve dhe krijimtarisë popullore (këngët, vallet, lojërat, legjendat, përrallat, mitet, etj.).

Në kuadër të koncepteve kryesore tematike, përfshihet:

Relacioni art-shoqëri që zhvillohet më tej, duke përfshirë aktivitetet e pjesëmarrjes në ekspozita artistike në klasë, shkollë apo komunitet; vizitat në galeri, muzeume, objekte të trashëgimisë kulturore, dhe duke identifikuar përfaqësuesit kryesot të periudhave të ndryshme artistike.

Fusha kurrikulare Artet në nivelin e dytë të arsimit ndër tjerash, synon të përmbushë këto aspekte themelore:

- *"Zhvillimin e qëndrimit pozitiv ndaj artit dhe kulturës materiale e shpirtërore popullore si pjesë e shumësisë së identitetve (si identiteti personal, lokal, kombëtar, global etj.)."*

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi – Lëndët: Historia, Gjeografia dhe Edukata Qytetare.

*Kjo fushë i ndihmon nxënësit për të kuptuar më mirë konceptet, proceset dhe zhvillimet historike në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe botëror, duke përfshirë lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve të ndryshme si dhe ngjarjet dhe personalitetet e rëndësishme nga kohët më të lashta deri më sot. Gjithashtu, ndihmon krijimin e shprehive, vlerave dhe qëndrimeve në raport me **diversitetin kulturor**, identitetin social **trashëgiminë kulturore dhe natyrore**, organizimin shoqëror, liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe rolin dhe funksionimin e institucioneve demokratike."*

Në kuadër të koncepteve të përgjithshme të kësaj fushe, përfshihet edhe Koncepti: Proceset shoqërore dhe natyrore, i cili përfshin: "...njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet e shoqërisë lidhur me ecuritë e popullsisë, vendbanimeve, migrimeve, proceset socio-ekonomike, si dhe **diversitetit kulturor** dhe natyror, komunikimit kulturor, teknologjisë dhe çështjeve të globalizmit."

Kurse Koncepti Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm, ndër tjerash, "përfshin edhe njohuritë mbi hapësirën (Tokën dhe Sitemin Diellor), dukuritë dhe proceset natyrore dhe socio-gjeografike, të regjioneve, si dhe njohuritë për **monumentet e trashëgimisë natyrore e kulturore dhe kujdesin për to.**"

Rezultatet e pritura nga kjo fushë për këtë cikël të arsimit, përmbajnë arritjen e njohurive bazë të nxënësve për:⁵

- Njohjen e rëndësisë së monumenteve, dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore.
- Të kuptuarit e procesve dhe dukurive të ndryshme shoqërore dhe natyrore dhe ndërvlerësive e njeriut me natyrën, dhe respekti për trashëgiminë kulturore e natyrore.
- Mësimi i zbatimit të normave dhe rregullave shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet, duke identifikuar dhe respektuar llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme, dhe duke analizuar sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë.

Në pjesën ku paraqitet metodologjia e përgjithshme, kurrikula sugjeron shfrytëzimin e metodave të ndryshme, në bazë të rrethanave dhe mundësive, sikurse:

- I intervistës dhe historisë gojore (rrëfimet, kujtimet) për mbledhjen e të dhënave për ngjarjet, vendet, personalitetet dhe mënyrën e jetesës;
- I debatit sepse krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathtësi të të menduarit kreativ, aftësi bashkëpunuese, socializim;
- Organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve zhvillojnë te nxënësit aftësitë e hulumtimit dhe vëzhgimit, interpretimit dhe diskutimit për dukuri të ndryshme natyrore dhe mjedisore;
- Bashkëpunimi me institucionet, grupet e interesit dhe me shoqërinë civile, janë forma të tjera të punës që realizohen edhe jashtë hapësirës shkollore.

Gjithashtu edhe në këtë cikël të arsimit të mesëm të ulët rekomandohen aktivitetet jashtëkurrikulare të organizuara për nxënës që do të mbështesin procesin e mësimdhënies dhe të nxënësit në fushat e ndryshme të kurrikulës. Këto aktivitete janë të njëjta me aktivitetet e Arsimit të hershëm dhe fillor.

Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë të Kosovës (klasa 10-12)

Fusha: Artet - Lëndët: Edukatë Figurative dhe Edukatë Muzikore

Në tekstin hyrës ku shtjellohet tema e kësaj fushe, përkufizimi i Arteve përfshinë krijimtarinë artistike autoriale por edhe **elemente të trashëgimisë kulturore lokale, kombëtare e universale** të manifestuar përmes kulturës, artefakteve, objekteve dhe krijimtarisë popullore (këngët, vallet, lojërat, legjendat, përrallat, mitet, etj).

Në kuadër të fushës së Artit figurativ, koncepti: relacioni art-shoqëri, zhvillohet më tej, më ç'rast rezultatet e pritura nga nxënësit përfshijnë: Identifikimin dhe elaborimin

⁵ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët (Klasa 6-9)*, faqe 66, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-berthame-2-final.pdf>, qasur Qershor 2020.

me shkrim, me gojë ose me forma të tjera të prezantimit, rolin e artit dhe të zhvillimeve artistike në kontekstin kulturor dhe atë historik në periudhat e ndryshme të zhvillimit shoqëror; Përshkruajnë dhe kategorizojnë vepra të ndryshme të artit dhe objekte të trashëgimisë kulturore sipas periudhës historike, kulturës, stilit dhe artistit, dhe të njohin dhe krahasojnë tradita të ndryshme artistike në periudha të ndryshme historike.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi – Lëndët: historia, **edukata qytetare**, sociologjia, psikologjia, filozofia dhe logjika.

“Kjo fushë i ndihmon nxënësit për të kuptuar analizuar dhe vlerësuar konceptet, idetë, proceset ndryshimet historike, shoqërore, lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve, strukturat shoqërore e mjedisore si dhe ngjarjet dhe rolin e personaliteteve të shquara dikur dhe tani në nivel lokal, shtetëror, kombëtar, rajonal, evropian dhe botëror.

Njohuritë në këtë fushë ndihmojnë nxënësin për të thelluar të kuptuarit mbi individin, shoqërinë vendet dhe mjedisin, në krijimin e shprehive, vlerave, qëndrimeve dhe gjykimeve në raport me diversitetin kulturor, identitetin social e psikologjik, trashëgiminë kulturore e natyrore, organizimin shoqëror, liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe rolin dhe funksionimin e institucioneve demokratike.”

Në kuadër të koncepteve të përgjithshme të kësaj fushe, përfshihet edhe Koncepti: Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm, ndër tjerash, *“përfshin njohuritë, vetëdijesimin për angazhimin e ruajtjes së mjedisit, resurseve dhe energjisë, kujdesin për objektet e trashëgimisë kulturore e natyrore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.”*

Rezultatet e pritura nga kjo fushë për këtë cikël të arsimit, përmbajnë arritjen e njohurive bazë të nxënësve për:⁶

- Hulumtimin e monumenteve, dukurive, proceseve historike, shoqërore, natyrore.
- Hulumtimin e të dhënave që ndërlidhen me identitetin si: traditat, rregullat, besimet, mitet, legjendat, arkitekturën autoktone, monumentet, veshjet, ushqimet, etj., e popullit të vet dhe të popujve të tjerë; shpjegon vlerat e identitetit kombëtar, rajonal, evropian dhe global.
- Kontribuimin në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në pjesën ku paraqitet metodologjia e përgjithshme, kurrikula sugjeron shfrytëzimin e metodave të ndryshme, në bazë të rrethanave dhe mundësive, sikurse:

- I intervistës dhe historisë gojore (rrëfimet, kujtimet) për mbledhjen e të dhënave për ngjarjet, vendet, personalitetet dhe mënyrën e jetesës;
- I debatit sepse krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathtësi të të menduarit kreativ, aftësi bashkëpunuese, socializim;

⁶ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (Klasa 10-12)*, faqe 65, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-berthame-3-final.pdf>, qasur Qershor 2020.

- I vrojtimit dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me mjedisin shoqëror, organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve zhvillojnë te nxënësit aftësitë e hulumtimit dhe të vëzhgimit, të interpretimit dhe të diskutimit për dukuri të ndryshme shoqërore dhe mjedisore.
- Bashkëpunimi me institucionet, grupet e interesit dhe me shoqërinë civile, janë forma të tjera të punës që realizohen edhe jashtë hapësirës shkollore.

Gjithashtu edhe në këtë cikël të arsimit të mesëm të lartë rekomandohen aktivitetet jashtëkurrikulare të organizuara për nxënës që do të mbështesin procesin e mësimdhënies dhe të nxënës në fushat e ndryshme të kurrikulës. Këto aktivitete janë të njëjta me aktivitetet e dy cikleve paraprake.

2.2. Komuna e Istogut – Profil i sektorit të Arsimit

Në bazë të statistikave të edukimit, në Komunën e Istogut gjenden 11 shkolla fillore amë dhe 15 paralele të ndara (Klasa 1-9), dhe dy institucione shkollore për mesim të mesëm të lartë.

Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, 10 shkolla amë janë shkolla ku zhvillohet mësimi vetëm në gjuhën shqipe, 2 shkolla amë janë në gjuhën serbe, dhe 1 shkollë amë është e përzier, me mesim që organizohet në gjuhën shqipe (për paralelet shqiptare) dhe gjuhën boshnjake (për paralelet boshnjake). Në shkollimin fillor gjithsej janë të regjistruar 7172 nxënës në 308 paralele, që i bie mesatarja 17 nxënës në një paralele.⁷

Disa nga dobësitë e paraqitura që ndikojnë në efikasitetin e mësimi është evidentuar distanca më e madhe se ajo e lejuar, si rezultat i shpërndarjes së banimit me dendësi shumë të vogël të ndërtimit, joefikasiteti i shfrytëzimit të ndërtesave shkollore, në dy fshtara, me numër shumë të vogël të nxënësve, si dhe pasiguria e nxënësve të cilët duhet të kalojnë nëpër rrugë regjionale e primare- lokale, gjatë relacionit shtëpi-shkollë dhe anasjelltas.⁸

Në fushën e arsimit të mesëm të lartë, në komunën e Istogut veprojnë vetëm dy institucione. Gjimnazi "Haxhi Zeka" në Istog dhe Shkolla e Mesme Teknike "Mithat Frashëri" në fshatin Gjurakoc, me paralelen e ndarë e cila funksionon brenda burgut të Dubravës.⁹

Numri i përgjithshëm i nxënësve të cilët vijnë mësimin e mesëm të lartë në këtë komunë është 1967. Nxënësit janë nga tërë territori i komunës, të cilët detyrohen të udhëtojnë në relacion shtëpi – shkollë në baza ditore.

⁷ Komuna e Istogut, *Plani Zhvillimor Komunal Istog 2018-2026*, faqe 63, <https://kk.rks-gov.net/istog/wp-content/uploads/sites/13/2018/02/Plani-Zhvillimor-Istog-tekti.pdf>, qasur qershor 2020.

⁸ Ibid, faqe 63.

⁹ Ibid, faqe 63.

Edhe në këtë nivel, një prej problemeve të paraqitura është distanca e madhe e udhëtimit për të arritur në shkollë, sidomos nga vendbanimet rurale më të largëta dhe të atyre malore-kodrinore.¹⁰

Për të pasur një pasqyrë më të plotë të profilit të arsimit, Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit është kontaktuar, dhe janë siguruar të dhëna në lidhje me çështjet specifike, që kanë të bëjnë me trajtimin e trashëgimisë kulturore në kurrikulën mësimore në këtë komunë.

Në bazë të dhënave të siguruara nga Drejtoria komunale për Arsim¹¹, tema e trashëgimisë kulturore trajtohet në kuadër të kurrikulës mësimore, në veçanti në kuadër të lëndëve Gjuhë Shqipe, Histori, Edukatë Qytetare dhe Art Muzikor, por duke lënë hapësirë për më tepër mundësi dhe kohë për angazhim në këtë drejtim.

Si aktivitete jashtëkurrikulare që më së shumti organizohen janë listuar: Lojërat e ndryshme në kuadër të edukatës fizike, programe muzikore me këndim, recitim, programe letrare me recitim, hartim të eseve, pikturë, si dhe vizita të nxënësve në lokalitete dhe monumente të trashëgimisë kulturore. Aktivitete jashtëkurrikulare organizohen me rastin e shënimit të festave zyrtare në nivel kombëtar, dhe ditët e veçanta të shkollës.

Vizitat në Muzeun Komunal të Istogut janë përfshirë në kuadër të planprogramit mësimor të shkollave në komunën e Istogut. Sfidë kryesore e cila paraqitet për realizimin e këtij aktiviteti, është aspekti financiar dhe logjistik për organizim të transportit të nxënësve, dhe shpenzimet tjera që ndërlidhen me organizim të vizitave jashtë qytetit/fshatit, ku gjendet shkolla.

Sa i përket aspektit të furnizimit të shkollave me pajisje logjistike për organizim të aktiviteteve jashtëkurrikulare, shkollat e Komunës së Istogut posedojnë mjete të kufizuara, kryesisht për organizim të shfaqjeve dhe programeve muzikore, sikurse veshjet tradicionale dhe veglat muzikore. Kurse pajisjet bashkëkohore, sikurse lloptopë, projektor, kamera digjitale janë mungesë.

Në mënyrë që të planifikohen aktivitete jashtëkurrikulare, me theks të veçantë aktivitete shtesë që kanë në fokus trajtimin e trashëgimisë kulturore, nevojitet një planifikim buxhetor dhe mbështetje financiare shtesë.

2.3. Komuna e Istogut – Institucionet Kulturore

Në qytetin e Istogut, infrastruktura e institucioneve publike kulturore përbëhet nga Shtëpia e Kulturës, e cila në kuadër të saj përfshin edhe Muzeun Arkeologjik Komunal, dhe nga Biblioteka e Komunale e Istogut.

¹⁰ Ibid, faqe 64.

¹¹ Naim Sadriu – Zyrtar për standarde, monitorim dhe vlerësim – DKA Istog, Intervistë me shkrim më datën 17.06.2020.

Në shtëpinë e Kulturës në Istog organizohen aktivitetet kryesore nga fusha e kulturës, duke filluar nga aktivitete për fëmijë deri te të rriturit.¹² Disa nga festat zyrtare që shënohen në Shtëpinë e Kulturës: Manifestimi i Ditës së Pavarësisë së Kosovës, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Festa e Flamurit – 28 Nëntori, Festivali mbarëkombëtar i folklorit, Festivali i fëmijëve dhe ekspozita të ndryshme të nxënësve të shkollave në Komunën e Istogut. Në shtëpinë e kulturës zhvillohen gjithashtu edhe aktivitetet e ansamblit komunal "Selmon Kadria" dhe korit të fëmijëve në kuadër të këtij ansambli, si dhe aktivitetet e Trupës teatrale të kësaj komune.

Në hollin hyrës, në përdhësë të Shtëpisë së Kulturës, gjendet ekspozita e Muzeut Arkeologjik Komunal, ku janë të prezantuar artefakte nga perioda e neolitit, Ilire, Romake e deri në Mesjetë. Këto artefakte janë gjetur në territorin e Komunës së Istogut.¹³ Krahas ekspozitës së përhershme, organizohen edhe ekspozita tematike. Sipas të dhënave të siguruara, numri i vizitorëve dhe interesimi për Muzeun Arkeologjik Komunal, nuk është në nivel të kënaqshëm.¹⁴

Biblioteka Komunale e Istogut përfshin një fond të gjërë të librave, rreth 16000 libra, ku edhe interesimi për lexim është në nivel të kënaqshëm.

Aktivitetet kulturore në vendbanimet tjera të komunës zhvillohen kryesisht në Qendrat e Komunitetit.

2.4. Trashëgimia Kulturore në nivel qendror – fokusi në fushën e edukimit dhe ngritjes së vetëdijes

Korniza institucionale dhe ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore

Menaxhimi i trashëgimisë kulturore në kuadër të sistemit të administratës publike bëhet nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal.

Në nivelin qendror, **Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore** është agjenci e pavarur e themeluar në vitin 2007, nga Kuvendi i Kosovës në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe në bazë të Ligjit për Trashëgimi Kulturore Nr. 02/L-88. Mandati kryesor i Këshillit fokusohet në vlerësimin dhe shpalljen e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, vlerësimin e projekteve dhe përcaktimin e prioriteteve financiare në fushën e trashëgimisë kulturore, dhe bashkëpunimin me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për avancimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e themeluar në vitin 2002, paraqet institucionin kryesor qendror për menaxhimin e fushës së kulturës në përgjithësi në

¹² Drin Sadikaj – Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport- Komuna Istog, Intervistë me shkrim më datën 07.06.2020.

¹³ Boletini Enver, Muzeu Arkeologjik në Istog, Kohavision – KTV, 2018, <https://www.youtube.com/watch?v=BaoJ90Ik5ak> qasur qershor 2020.

¹⁴ Drin Sadikaj – Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport- Komuna Istog, Intervistë me shkrim më datën 07.06.2020.

Kosovë. Departmaneti i Trashëgimisë Kulturore në kuadër të kësaj Ministrie, nëpërmjet institucioneve vartëse paraqet organin përgjegjës për menaxhim dhe ruajtje të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Ky departament ka në vartësi: Institutin e Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve, Institutin Arkeologjik të Kosovës, Muzeun Kombëtar të Kosovës dhe Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore, nëpërmjet të cilëve zhvillohen politikat programore për zhvillim të strategjive për inventarizim, ruajtjen dhe mbrojtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore, hartimin e planeve të ndërhyrjeve për ruajtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore.

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Pejë është institucion vartës i MKRS, dhe është përgjegjës për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në Komunën e Pejës, Deçanit dhe të Istogut. Në kuadër të përgjegjësi të përcaktuara në rregulloren e (MKRS) nr. 06/2017, përfshihen inventarizimi i trashëgimisë kulturore në territorin e komunave për të cilat është përgjegjës, vlerësimi dhe propozimi i aseteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme, njoftimi i pronarëve të objekteve që përfshihen në listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje, bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror dhe ato lokal, në inventarizimin, mbrojtjen dhe propozimin e hapave për ruajtjen dhe promovimin e aseteve të trashëgimisë kulturore.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është themeluar në vitin 2002, dhe ka mandat kryesor në krijimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm në fushën e mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit e banimit. Në bazë të legjislacionit të adoptuar, kjo Ministri është përgjegjëse për zbatim dhe implementim të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, si dhe për ruajtjen dhe integrimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në planet hapësinore.

Në nivelin lokal, **Komuna e Istogut** është institucion përgjegjës për menaxhim të zhvillimit të qytet. Çështjet në lidhje me trashëgiminë kulturore trajtohen nëpërmjet Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me institucionet kompetente të nivelit qendror.

Ligji (Nr. 02/L-88) për Trashëgiminë Kulturore është aprovuar në vitin 2006, dhe paraqet mjetin ligjor për rregullim të procesit të inventarizimit, dokumentimit, përzgjedhjes, mbrojtjes, ruajtjes, restaurimit, zhvillimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në përputhje me kartat dhe konventat ndërkombëtare. Ky ligj ka për synim përcaktimin e skemës organizative të institucioneve kompetente të cilët do të miren në mënyrë të drejtpërdrejtë me zbatimin e përgjegjësi të dala nga ky ligj.¹⁵

Ligji (Nr. 04 – L/174) për Planifikim Hapësinor është adoptuar së pari në vitin 2003, kurse në vitin 2013 është amandamentuar. Ky ligj ka për qëllim promovimin e një zhvillimi racional të planifikimit hapësinor, duke arritur një balancë ndërmjet zhvillimit dhe ruajtjes së hapësirave si dhe ruajtjen e ambientit.¹⁶ Integrimi i

¹⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Trashëgiminë Kulturore, <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,205>, qasur Qershor 2020.

¹⁶ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Planifikim Hapësinor, Prishtinë, 2013, <http://www.assemblykosova.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20spatial%20planning.pdf>, qasur Qershor 2020.

trashëgimisë kulturore në procesin e planifikimit hapësinor urban trajtohet me qasjen e konservimit të integruar që ka paraqitur një koncept të ri për institucionet e Kosovës.

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Trashëgimi Kulturore 2017-2027

Kjo strategji është hartuar në vitin 2017¹⁷ është një strategji gjithëpërfshirëse e Qeverisë së Kosovës në fushën e trashëgimisë kulturore, e cila synon vendosjen e kornizave afatgjata për vizionin dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimin e qëndrueshmërisë.

Me këtë Strategji, trashëgimia kulturore përcaktohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, që do të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes efektive në avansimin e sistemit të mbrojtjes.

Në kuadër të synimeve të strategjisë, përcaktohet edhe Edukimi, promovimi dhe ndërgjegjësimi qytetar më qëllim të nxitjes së identitetit kulturor. Në bazë të synimeve janë grupuar edhe objektivat e planit, ku si objektivi i veçantë është paraqitur edhe: Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Gjatë elaborimit të kësaj objekte vërehet që vëmendje të veçantë i ipet ndërtimit të kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore, mbrojtja e të drejtave të pronarëve, poseduesve të pronave kulturore, sigurimi i qasjes për të gjithë në trashëgiminë kulturore dhe edukimi i gjeneratave të reja mbi trashëgiminë.

Në objektivin specifike mbi edukimin e gjeneratave të reja, ceket përfshirja e trashëgimisë kulturore në kurrikulat mësimore, që synon vendosjen e kornizës për edukim të vazhdueshëm teorik dhe të praktikës profesionale në fushën e trashëgimisë kulturore. Masë e rëndësishme në këtë drejtim është vendosja e bashkëpunimit afatgjatë dhe të strukturuar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Trashëgimia Kulturore në Komunën e Istogut

Territori i Komunës së Istogut është i pasur me trashëgimi kulturore të palëvizshme dhe të lëvizshme, e cila është e kategorizuar si Trashëgimi Arkeologjike, Trashëgimi Arkitekturale dhe Trashëgimi e luajtshme.

Në kategorinë e trashëgimisë arkeologjike në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje të përkohshme 2019-2020, gjenden gjithsej 26 asete, ku 5 prej tyre janë në nënkategorinë: monument / ansambël, kurse 21 në nën kategorinë: lokalitet

¹⁷ Jerliu Florina, *Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027*, MKRS, Prishtinë, 2017, http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/shqip_strategjia_per_trashegimi.pdf, qasur Qershor 2020.

arkeologjik / rezervat.¹⁸ Tri nga asetet në këtë kategori, njëkohësisht janë edhe Zona të Veçanta të Mbrojtura, sipas Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

Në qoftë se analizojmë përbërjen e kësaj kategorie, mund të konkludojmë që territori i Komunës së Istogut është shumë i pasur me lokalitete arkeologjike që datojnë që nga koha e parahistorisë, periudha antike, antikiteti të vonë dhe mesjetare të hershme.

Në kategorinë e trashëgimisë arkitekturore, në nën kategorinë: Monument / Ansambël gjenden gjithsej 35 asete. Në kuadër të aseteve të listuara nën mbrojtje të përkohshme kryesisht dominojnë Kullat e Gurit, Mullinjtë e vjetër, dhe Xhamitë e vjetra. Si tipologji më e rrallë në listë janë edhe ndërtesat publike, sikurse shkolla e vjetër në fshatin Dobrushë dhe Banja e Pejës.

Kurse në kategorinë e Trashëgimisë së Luajtshme, gjenden katër objekte që datojnë ngashek. VI-V p.Kr, dhe periudha e vonë Romake.

Bashkë me trashëgiminë materiale, pjesë e pa shkëputur e trashëgimisë është edhe trashëgimia shpirtërore, ku përfshihen traditat, zakonet, besimet e ritet. Si pjesë veriore e rrafshit të Dukagjinit, trashëgimia shpirtërore në Komunën e Istogut ka edhe ngjashmëritë dhe veçantitë në këtë kontekst.¹⁹ Nga elementet e trashëgimisë shpirtërore veçojmë: Shënimi i ngjarjeve të vitit kalendarik - ritet e jetës, dhe folklori – tradita muzikore e Podgurit, ku krahas muzikës shquhen edhe veglat muzikore, vallëzimet popullore dhe veshjet tradicionale.

¹⁸ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Lista e trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme, https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Lista_e_Trashegimise_Kulturore_per_Mbrojtje_te_Perkohshme_2018.pdf qasur Qershor 2020.

¹⁹ Komuna e Istogut, *Plani Zhvillimor Komunal Istog 2018-2026*, faqe 78-87, <https://kk.rks-gov.net/istog/wp-content/uploads/sites/13/2018/02/Plani-Zhvillimor-Istog-teksiti.pdf>, qasur qershor 2020.

III. Propozimet

Në këtë pjesë të udhëzuesit do të paraqiten propozime të ndryshme që kanë për qëllim që të nxisin mësimdhënësit që kanë dëshirë të avancojnë dhe të përforcojnë metodat e mësimdhënies, duke përfshirë aktivitete të ndryshme që do të ndikojnë në të kuptuarit më të qartë dhe praktik të fushës së trashëgimisë kulturore, dhe rolin e saj në kontekstin ku jetojmë.

Objektiva kryesore e aktiviteteve të propozuara është frymëzimi dhe forcimi i përkushtimit të nxënësve për të njohur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore, dhe për të ndihmuar në plotësimin e zbrazëtirës ndërmjet shkollës dhe shoqërisë, duke ofruar aktivitete stimuluese që promovojnë përfshirjen në komunitet.

Aktivitetet e praqitura më poshtë bazohen në metodologjinë e propozuar në Kurrikulën Bërthamë²⁰:

- a. *Mësimdhënia dhe të nxënit me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja – i cili kërkon që procesi i planifikimit dhe i organizimit të mësimdhënies të mbështetet në përvojat individuale të nxënësve, në potencialet, nevojat dhe interesimet e tyre.*
- b. *Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar - i cili është në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore, duke bërë ndërlidhjen e fushave kurrikulare / lëndëve mësimore, ku përmbajtet e veçanta dhe të përbashkëta mësimore ndihmojnë njëra tjetrën në zhvillimin e kompetencave kryesore për shkallë kurrikulare.*
- c. *Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar – ku mësimdhënia mbështetet në planifikim, zbatim, kontroll, përkrahje dhe vlerësim të kapaciteteve mendore dhe fizike të nxënësit.*
- d. *Çështjet/temat ndërkurrikulare – përfshinë hapësirën për mësim përtej kufijve lëndorë, në atë mënyrë që fëmijët të mund të ndërtojnë lidhje mes fushave të kurrikulës dhe lëmenjve të ndryshëm.*
- e. *Veprimtaritë/aktivitetet jashtëkurrikulare - aktivitete të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të fushave dhe lëndëve mësimore, por që e ndihmojnë arritjen e kompetencave për shkallë të kurrikulës.*

Përjetimi dhe interpretimi i vlerave të trashëgimisë kulturore si principe kryesore²¹

Gjatë elaborimit dhe propozimit të aktiviteteve praktike, duhet të merren parasysh karakteristikat dhe nevojat e grupmohave të ndryshme që synohen.

Trashëgimia për nxënësit e edukimit primar: Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta

Pikat kryesore që duhet të konsiderohen:

²⁰ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (Klasa 10-12)*, faqe 102-110, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-berthame-3-final.pdf>, qasur Qershor 2020.

²¹ Interpret Europe, *Engaging citizens with Europe's cultural heritage* (Përfshirja e qytetarëve në trashëgiminë kulturore të Europës), Witzenhausen, 2017, faqe 25-29, https://interpret-switzerland.org/wp-content/uploads/2018/02/ie_engaging_citizens_with_europes_cultural_heritage.pdf, qasur Qershor 2020.

- Trashëgimia Kulturore duhet të elaborohet nëpërmjet tregimeve të interpretuara, të cilët e bëjnë ndërlidhjen ndërmjet të kaluarës me fushën e përjetimit të nxënësve, dhe mundësojnë aktivizimin e ndjeshmërisë;
- Interpretimi duhet të përforcojë ndjenjën e realitetit nëpërmjet theksimit të përjetimeve të drejtpërdrejta të fenomeneve që ndërlidhen me mjedisin e familjes, të shtëpisë, dhe vendbanimit ku jetojnë;
- Interpretimi i vlerave të trashëgimisë duhet të nxit kuriozitetin e nxënësve dhe të ngjallë krijimtarinë brenda tyre.

Trashëgimia për nxënësit e shkollave të mesme të larta

Pikat kryesore që duhet të konsiderohen:

- Trashëgimia kulturore duhet të elaborohet nëpërmjet tregimeve të cilët ndërlidhin vlerat specifike të trashëgimisë me besimet dhe vlerësimet që kanë rëndësi për të rinjtë;
- Interpretimi duhet të përfshijë këndvështrime të shumta që zbulojnë domethënien e një trashëgimie të veçantë për palë të ndryshme (p.sh. me prejardhje të ndryshme socio-kulturore);
- Interpretimi duhet të shtrojë pyetje të hapura që provokojnë ndërveprim, debat dhe frymëzim për vetë-reflektim;
- Interpretimi emancipues duhet të respektojë autonominë e individit dhe mendimin e tij;

Në vijim do të ilustrohen disa propozime nga përvojat e zhvilluara në Kosovë, rajon dhe në Europë, dhe për secilin propozim do të elaborohet përshtatshmëria e aplikimit në shkollat e Komunës së Istogut, kur mund të aplikohen, si mund të zhvillohen, për cilët grup-mosha dedikohet, dhe kush është bartës potencial i zbatimit të aktivitetit në fjalë.

1. Doracak për Mësimdhënës: Njësi mësimore për Trashëgiminë Kulturore dhe Diversitetin Kulturor

Gjatë periudhës në mes të viteve 2010-2015 organizata ndërkombëtare Këshilli i Europës, nëpërmjet projektit: Promovimi i Diversitetit Kulturor të Kosovës, ka organizuar një seri të aktiviteteve me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe edukimit të gjeneratave të reja në lidhje me potencialet dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe diversitetit (shumëllojshmërisë) kulturor të Kosovës. Në kuadër të këtij projekti janë organizuar vizita edukative (HAJDE) me rreth 5000 pjesëmarrës, përfshirë nxënës mësimdhënës dhe prindër, të 20 shkollave fillore në Kosovë; diskutime të përbashkëta, trajnime të mësueve për trashëgiminë kulturore; dhe hartimi i doracaktu: "Doracak për mësimdhënës: Njësi mësimore për trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor"²². Në vitin 2015 ky doracak është aprovuar nga ana e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si një mjet ekstra kurrikularë në fushën: Shoqëria dhe Mjedis, për klasët 3-9. Në këtë projekt dhe përgaditje të doracakut, nga komuna e Istogut kanë marrë pjesë mësimdhënës nga Shkolla Fillore "Hysni Zajmi". Në bazë të komunikimit me Drejtorinë Komunale për Arsim, gjatë kohës së trajnimit, në shkollat e Komunës së Istogut ende nuk zbatohet Kurrikula e re mësimore.²³

Në kuadër të këtij doracaku paraqiten tetë njësi mësimore, të cilët përmbajnë:

- **Informacionin paraprak** - elaborohet qëllimi i njësisë dhe mënyra si paraqitet tema e caktuar;
- **Rezultatet e të nxënësve** – paraqitet lista e indikatorëve të rezultateve të të nxënësve, pas zbatimit të njësisë mësimore;
- **Materialet dhe përgatitjet praktike** – lista e materialeve të nevojshme për të përgatitur aktivitetin në lidhje me njësinë mësimore;
- **Procedura** – ku në mënyrë të hollësishme elaborohet zhvillimi i aktivitetit, ndarja e nxënësve në grupe, udhëzimet për punë në grupe, diskutimi në grupe, prezantimi i rezultateve të punës grupore; dhe hapja e debatit në lidhje me rezultatet e prezantuara, ku secili nxënës mund të flet rreth mendimit të tij në lidhje me temën e prezantuar.
- **Këshilla për mësimdhënës** – paraqiten variantet e ndryshme të aktivitetit, që mund të zhvillohen në varësi të kushteve me të cilët posedon shkolla, si dhe aktivitetet pasuese që mund të kërkohet të plotësohen nga nxënësit si detyrë shtëpie.

²² Këshilli i Europës, *Doracak për mësimdhënës – Njësi mësimore për trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor*, Prishtinë, 2012, <https://rm.coe.int/16806ae5c8>, qasur Qershor 2020.

²³ Naim Sadriu – Zyrtar për standarde, monitorim dhe vlerësim – DKA Istog, Intervistw me shkrim mw datwn 17.02.2020.

Zbatimi i Doracakut në Shkollat e Komunës së Istogut

Në mënyrë që ky doracak të mund të shfrytëzohet nga shkollat e Komunës së Istogut, fillimisht duhet të organizohet një trajnim i mësimdhënësve për përmbajtjen dhe aktivitetet e propozuara në doracak.

Një program i trajnimit për mësimdhënës është përgaditur nga ekipi i projektit Promovimi i Diversitetit Kulturor të Kosovës. Ky program trajnimi dy ditor për mësimdhënësit fokusohet në komponentët e trashëgimisë kulturore dhe diversitetit kulturor.²⁴ Dokumenti përmban programin e trajnimit, me të dhëna të hollësishme rreth mënyrës së organizimit. Ky trajnim duhet të udhëhiqet nga një ekspert i fushës së edukimit dhe një profesionist të fushës së trashëgimisë kulturore.

Duke marrë parasysh që në këtë projekt tashmë është përfshirë një shkollë nga Komuna e Istogut, dhe doracak është aprovuar nga MASHT në kuadër të kurrikulës mësimore supozojmë se organizimi i trajnimit për mësimdhënës dhe zbatimi i njësive mësimore nga doracak janë hapa që mund të realizohen në shkollat e kësaj komune. Në këtë rast, mësimdhënësit nga shkolla 'Hysni Zajmi' mund të shërbejnë si asistues në trajnim.

Doracak përmban tetë njësi mësimore, ku përfshihen temat:

1. Trashëgimia dhe diversiteti;
2. Trashëgimia Kulturore e prekshme;
3. Trashëgimia natyrore;
4. Trashëgimia jomateriale;
5. Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore;
6. Diversiteti – identiteti jonë;
7. Diversiteti: perceptimet e ndryshme;
8. Diversiteti: respektimi dhe pranimi i ndryshimeve.

Trajtimi i temave dhe aktiviteteve në njësitë mësimore, janë në përputhje me kurrikulën mësimore për Shkollat fillore – Klasat 3-5, dhe Shkollat e arsimit të mesëm të ulët – Klasat 6-9, në kuadër të Lëndës: Shoqëria dhe Mjedisi.

Iniciativa për trajnim të mësimdhënësve, integrim të doracakut në kurrikulën mësimore dhe zbatim të tij, duhet të vjen nga Drejtoria për Arsim e Komunës së Istogut në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

²⁴ Otting Jenny & Veton Sylhasi, *Program trajnim – mësimi mbi trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor*, Prishtinë, 2013, <https://rm.coe.int/16806ae6af>, qasur Qershor 2020.

2. Doracak: Hyrje në Trashëgimi Kulturore – Vetëdijesimi i të Rinjëve për Vlerat e Trashëgimisë Kulturore

Doracaku është hartuar nga ekspertët e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren gjatë vitit 2019²⁵. Ky doracak ka për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e të rinjëve mbi vlerat e trashëgimisë kulturore dhe angazhimin e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Doracaku përmban informata në lidhje me atë se çka kuptojmë më trashëgimi kulturore, rëndësinë e mbrojtjes së saj, kategorizimin e trashëgimisë kulturore, prezantimi i përgjithshëm për secilën kategori të trashëgimisë kulturore, të shoqëruar me pamje ilustruese.

Informatat në doracak janë të renditura si në vijim:

- Çka është trashëgimia kulturore?
- Pse është e rëndësishme dhe pse duhet të ruhet?
- Rreziqet që i kanosen trashëgimisë kulturore
- Pse duhet të vetëdijesohen të rinjtë mbi trashëgiminë kulturore?
- E kujt është trashëgimia kulturore?
- Si ndahet trashëgimia kulturore?
- Trashëgimia arkitekturore
- Trashëgimia arkeologjike
- Trashëgimia e lëvizshme
- Trashëgimia shpirtërore

Zbatimi i Doracakut në Shkollat e Komunës së Istogut

Ky doracak, i kombinuar me doracakun e hartuar në kuadër të projektit Promovimi i Diversitetit Kulturor, mund të shërbejnë si literaturë shtesë, për të trajtuar temat në lidhje me trashëgiminë kulturore në kuadër të kurrikulës mësimore, respektivisht në kuadër të fushës: Shoqëria dhe Mjedisi.

Doracaku është hartuar nga ekspertët e Institucionit vartës të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe paraqet burim të hapur për shfrytëzim për të gjitha shkollat në territorin e Kosovës, përfshirë këtu edhe Komunën e Istogut.

Në mënyrë që dy doracak të mund të shfrytëzohet nga mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave të Komunës së Istogut, një prezantim i hollësishëm rreth përmbajtjes së doracakut, mund të bëhet nga ana e autorëve të doracakut. Ky aktivitet do të ishte në përputhje me rekomandimet për Aktivitetet jashtëkurrikulare, që mund të aplikohen nga shkollat, ku ndër tjerash propozohet: **Diskutimet me mysafirët** (d.m.th., me profesionistë të fushave të ndryshme, përfaqësues të institucioneve).

²⁵ Ahmetaj Rexhep, *Hyrje në Trashëgimi Kulturore – Vetëdijesimi i të Rinjëve për Vlerat e Trashëgimisë Kulturore*, MKRS, Prizren, 2019.

Mënyra e prezantimit dhe informatat e prezantuara në doracak, janë në përputhje me kurrikulën mësimore për Shkollat e arsimit të ulët të mesëm - Klasat 6-9, në kuadër të Lëndës: Shoqëria dhe Mjedis, Lëndët: Edukatë Qytetare dhe Histori.

3. Përdorimi i filmit në mësimdhënie

Filmat edukativ paraqesin filma të cilët kanë për qëllim primar edukimin në lidhje me një çështje të caktuar. Përdorimi i filmit në mësimdhënie ka filluar si një metodë alternative krahas edukimit klasik. Filmi është parë si një ndihmesë shumë e fuqishme, duke u mundësuar nxënësve të përjetojnë dhe të kuptojnë më mirë fenomenet / temat e trajtuara, si dhe duke përmirësuar efikasitetin e të nxënësve.

Në Kosovë, me iniciativë të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Shkurtër dhe Dokumentar DokuFest është zhvilluar projekti: Filmi dhe Media Faktuale. Në këtë projekt është bërë inkurajimi dhe fuqizimi i mësimdhënësve për përdorim efektiv të filmave dokumentar si mjet në procesin mësimor, si dhe fuqizimi dhe përgatitja e të rinjëve për prodhim të filmave dokumentar.

Në kuadër të këtij projekti janë shfaqur filma dokumentarë në 23 shkolla të 7 komunave të Kosovës, ku janë trajtuar tema të ndryshme që ndërlidhen me kurrikulën mësimore, sikurse: mbrojtja e ambientit, procesi reciklues, identiteti kulturor, krimet kibernetike etj.

Mësimdhënësit nga shkollat e përzgjedhura kanë qënë pjesë e sesioneve trajnuese, të cilët kanë ndihmuar në pasurimin e bibliotekës digjitale të mësimdhënësit, që tani është e disponueshme për të gjithë mësimdhënësit në Kosovë.

Si rezultat i këtij projekti, është hartuar një platformë digjitale²⁶ e pasuruar me bibliotekën digjitale të mësimdhënësit, ku mësimdhënësit mund të zgjedhin filma për fusha të ndryshme të kurrikulës mësimore për Arsimin e mesëm të lartë (Klasat 9-12), dhe Arsimin Universitar. Në këtë bibliotekë paraqiten fushat e kurrikulës, ku ndër tjerash është edhe lënda e Edukatës Qytetare, e cila trajton temën e Trashëgimisë Kulturore.

Për secilin film të disponueshëm në bibliotekën digjitale, paraqitet fleta e punës me udhëzimet për shfrytëzimin e filmit në klasë. Këto udhëzime janë punuar nga vetë mësimdhënësit, ku përfshihen:

Përshkrimi i filmit; Tema kryesore; Njësitë Mësimore – të cilët i përfshin filmi; **Fushat e Kurrikulës; Përshtatshmëria** për Klasat sipas shkallës kurrikulare; **Objektivat; Pikat e diskutimit** pas shfaqjes së filmit, dhe **Aktivitetet** në lidhje me filmin.

Pas zbatimit të këtij projekti në 23 shkolla të 7 komunave të Kosovës, është vlerësuar se përdorimi i filmit në klasë sjell përfitime të shumëfishta për nxënësit, duke zhvilluar të menduarit kritik dhe inkurajuar perspektiva të ndryshme, që vijnë si rezultat i diskutimit kritik të ngjarjeve historike. Përdorimi i filmit në mësimdhënie është në përputhje me njërin nga metodologjitë e mësimdhënies: Temat ndërkurrikulare, duke

²⁶ Dokufest, Biblioteka Digjitale e Mësimdhënësit, <https://dokufest-lab.com/teachers-digital-library/biblioteka-digjitale-e-mesimdhenesit/>, qasur Qershor 2020.

mundësuar trajtimin e temave jashtë lëndëve mësimore, dhe njëkohësisht duke krijuar ndërlidhje mes fushave të kurrikulës dhe jetës së përditshme.

Përdorimi i filmit në mësimdhënie në Shkollat e Komunës së Istogut

Kjo metodologji e cila është duke u shfrytëzuar nga një numër i shkollave në Kosovë, mund të aplikohet edhe në shkollat e Komunës së Istogut, respektivisht në shkollat e mesme, pra në Gjimnaz dhe Shkollën e Mesme Teknike.

Në mënyrë që kjo metodologji të mund të përdoret, Komuna mund të kërkojë përkrahje dhe bashkëpunim nga OJQ Dokufest, duke u bërë pjesë e këtij projekti.

Trajnimi i mësimdhënësve, pajisja me aparaturë përkatëse që do të mundësojë shfaqjen e filmave në klasë, janë disa nga hapat e parë për zbatimin e kësaj metodologjie.



FIGURA 1 SHFAQJA E FILMIT NË SHKOLLËN HYSNI ZAJMI NË GJAKOVË (BURIMI: DOKUFEST)

Përdorimi i filmit në mësimdhënie paraqet një metodë alternative, praktike, përmes së cilit nxënësit mund të kuptojnë në thelb fenomenet e ndryshme nga fusha e trashëgimisë kulturore. Filmi mund të përdoret për të plotësuar fushat kurrikulare për arsim të mesëm të lartë, sikurse: Edukatë Qytetare, Filozofi, Gjeografi, Gjuhë Angleze, Gjuhë Shqipe, Histori, Psikologji, Sociologji, Shoqëria dhe Mjedisi, dhe Edukim Mediatik (Si lëndë zgjedhore).

Përmbajtja e filmave dokumentar në Bibliotekën Digjitale është e përshtatshme për Shkollat e Mesme të Larta – Klasat 10-12.

Aktivitetet Jashtëkurrikulare

Propozimet në vijim hyjnë në kuadër të aktiviteteve jashtëkurrikulare të cilët shërbejnë për plotësimin e njohurive të fituara në kuadër të kurrikulës mësimore.

Organizimi i aktiviteteve jashtë shkollore rregullohet nëpërmjet Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016²⁷ të hartuar nga MASHT.

Ky dokument përcakton format e aktiviteteve jashtë shkollore, përshtatshmërinë për kategoritë mësimore, kohën kur rekomandohet të organizohen, dhe mënyra e organizimit ku përfshihet roli i mësimdhënësve dhe i këshillit të prindërve.

²⁷ Qeveria e Kosovës, Udhëzim Administrativ (MASHT) për Aktivitetet Jashtëshkollore, Prishtinë, 2016, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/01/ua-masht-nr-02-2016-per-aktivitetet-jashteshkollore-rotated.pdf>, qasur Qershor 2020.

4. Muzeu Mobil – Muzeu Kombëtar i Kosovës

Muzeu Kombëtar i Kosovës gjendet me seli në Prishtinë, dhe paraqet njërin prej institucioneve kryesore për dokumentim, inventarizim, mbrojtje dhe prezantim të trashëgimisë së luajtshme dhe shpirtërore në Kosovë²⁸.

Muzeu është i organizuar në sektorë të ndryshëm, etnologji, arkeologji, konservim të artefakteve, muzeologji dhe promovim. Krahas organizimit të ekspozitave të përhershme dhe të atyre tematike të përkohshme, Muzeu përfshin edhe programin e edukimit nëpërmjet Muzeut Mobil. Muzeu Mobil paraqet njërin prej iniciativave të para, të këtij lloji në Kosovë, ku vlerat e trashëgimisë kulturore arkeologjike, etnologjike dhe shpirtërore prezantohen në shkolla të ndryshme në tërë territorin e Kosovës, dhe më gjërë.

Muzeum mobil është i organizuar në një Kamionetë, ku në brendi të saj gjendet ekspozita arkeologjike, me artefaktet miniaturë nga ekspozita e përhershme e muzeut.

Më ftesë të shkollave, ekipi i Muzeut Mobil viziton shkollat përkatëse dhe zhvillon aktivitetet me nxënësit e klasave të arsimit të mesëm të ultë.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve përfshihet:

- Prezantimi i trashëgimisë arkeologjike, nëpërmjet ekspozitës arkeologjike në kamionetë;
- Zhvillimi i gjurmimeve të improvizuara arkeologjike së bashku me nxënësit;
- Prezantimi i ekspozitës etnologjike, përmes arkës etnologjike, ku prezantohen veshje, vegla dhe mjete të periudhave të ndryshme;
- Organizimi i aktivitetit: Sofra Shqiptare – ku nxënësit njoftohen me traditën dhe kulturën e jetesës në bashkësi, dhe rëndësisë së mbledhisë në një sofër;
- Diskutimi me nxënës me temën: “Një orë mbi rëndësinë e ruajtjes së Trashëgimisë Kulturore dhe Promovimi i Turizmit në Kosovë” – ekipi i Muzeut Mobil diskuton me nxënësit dhe mësuesit në lidhje me këtë temë;
- Lojëra të ndryshme me temë kryesore të trajtimit Trashëgimia Kulturore: Shkolla e mozaikut; Këndi i skulpturës; Lojëra tradicionale shqiptare; Këndi i leximit me të rinj, si dhe
- Pikturë/ vizatim- Prezantimi i vlerave kulturore, sociale nga të rinjtë përmes pikturës;

²⁸ Qeveria e Kosovës, Rregullore (MKRS) nr. 06/2017 për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente, Prishtinë, 2017, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16466>, qasur Qershor 2020.



FIGURA 2 AKTIVITETET E MUZEUT MOBIL NË SHKOLLAT E KOSOVËS (BURIMI: MUZEU KOMBËTAR I KOSOVËS)

Muzeu Mobil në Shkollat e Komunës së Istogut

Muzeu Mobil ka realizur vizita dhe aktivitete në një numër të madhë të shkollave në Kosovë, si dhe në shkollat shqipe edhe jashtë Kosovës.²⁹

Nëpërmjet këtij aktiviteti nxënësve iu mundësohet të kuptojnë vlerat e trashëgimisë kulturore përmes aktiviteteve të drejtpërdrejta, dhe njëkohësisht përvoja e vizitës në Muzeun Kombëtar, sjellet tek nxënësit që nga mosha e hershme. Aktivitetet e Muzeut Mobil rekomandohet të organizohen gjatë gjysëmvjetorit të dytë, respektivisht gjatë muajve të Pranverës, kur edhe kushtet atmosferike mundësojnë qëndrimin e nxënësve në ambient të hapur për një kohë më të gjatë. Vizita e Muzeut Mobil në shkolla mund të organizohet për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Muzeve, e cila është 18 Maj. Në këtë mënyrë nxënësit do të njoftohen për datat e rëndësishme ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore.

Ky aktivitet është vlerësuar i përshtatshëm për të gjithë nxënësit e Arsimit fillor dhe të Mesëm të Ulët, pra klasat 1-5 dhe 6-9.

Në mënyrë që një aktivitet i tillë të mund të realizohet edhe në shkollat e Komunës së Istogut, nevojitet një iniciativë bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Istogut dhe Muzeut Kombëtar të Kosovës.

²⁹ Muzeu Mobil, Muzeu Kombëtar i Kosovës, https://www.facebook.com/MuzeuMobil/?ref=page_internal, qasur Qershor 2020.

5. Vizita dhe ligjerata të profesionistëve të trashëgimisë kulturore në shkolla

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren, gjatë vitit 2018 ka organizuar projektin: "Edukimi i të rinjve mbi Trashëgiminë Kulturore". Ky projekt është realizuar në formë të ligjeratave të mbajtura në shkollat e ulëta të mesme. Qëllimi i këtyre ligjeratave ka qenë vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i nxënësve mbi nxënësit mbi rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, si pjesë përbërëse e identitetit kulturor.

30

Ligjeratat janë organizuar në kuadër të kurrikulës mësimore, në orët e lëndës Shoqëria dhe Mjedisit. Edukimi dhe formimi i hershëm i të rinjve mbi vlerat e trashëgimisë kulturore është vlerësuar si proces shumë i rëndësishëm, sepse në njërin anë përforcon ndjenjën e krenarisë dhe dashurisë për trashëgiminë e tyre kulturore, dhe në anën tjetër rritë respektin dhe tolerancën ndaj trashëgimisë së komuniteteve tjera. Edukimi në rini ofron perspektivë afatgjatë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe siguron vazhdimin e traditave në kohërat moderne. Ligjeratat janë mbajtur në shkollat e mesme të ulëta në fshatrat e pjesës perëndimore të komunës së Prizrenit.

Shkollat e Trashëgimisë – Historic England

Një përvojë të ngjashme, mbase më të avancuar kemi hasur edhe në Angli, në kuadër të Programit "Shkollat e Trashëgimisë" i cili implementohet nga Organizata Qeveritare Historic England³¹. Ky program ka filluar të zbatohet në vitin 2012, dhe ka arritur shtrirje në 400 shkolla në territorin e Anglisë. Heritage Schools ofron mbështetje për mësimdhënësit dhe profesionistët e fushës së edukimit për të ngritur njohuritë rreth vlerave lokale të trashëgimisë kulturore, dhe si të përfshihen këto në kurrikulën mësimore. Fillimisht mësimdhënësit trajnohen dhe njoftohen me informata të hollësishme rreth vlerave të trashëgimisë kulturore, duke u inkurajuar që të hulumtojnë në bibliografi, burime të shkruara, dhe të kontaktojnë shërbimet nga fusha e trashëgimisë: institucionet dhe organizatat civile.

Udhëheqësit e këtij programi punojnë ngushtë me ekipin drejtues të shkollave duke



FIGURA 3 PAMJE NGA AKTIVITETET E SHKOLLËS SË TRASHËGIMISË (BURIMI: HISTORIC ENGLAND)

³⁰ Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore, <https://www.facebook.com/qrtkpz>, qasur Qershor 2020.

³¹ Historic England, Shkollat e Trashëgimisë fituese të çmimit Europa Nostra, 2016, <https://historicengland.org.uk/whats-new/news/heritage-schools-programme-wins-major-eu-prize/>, qasur Qershor 2020.

koordinuar trajnimin e mësimdhënësve; ofruar mbështetje për zbatim të kurrikulës, dhe krijim të partneriteteve ndërmjet organizatave lokale të trashëgimisë dhe shkollat.

Secila shkollë e përfshirë në këtë program, ka përcaktuar një Mësues Udhëheqës i cili është përgjegjës për trajnimin e mësimdhënësve tjerë të shkollës.

Si rezultat i këtij programi, tani Shkollat i shfrytëzojnë vlerat lokale të trashëgimisë kulturore për të krijuar ndërlidhje ndërmjet nxënësve dhe vendbanimit, për të krijuar ndjenjën e vendit, dhe identitetit kulturor.

Mësimi rreth trashëgimisë kulturore lokale mbështet zbatimin praktik të kurrikulës mësimore, frymëzon kreativitet tek nxënësit, zhvillon vetëdijen rreth arkitekturës, artit dhe dizajnit, dhe inkurajon nxënësit që të vlerësojnë dhe mbrojnë trashëgiminë kulturore që i rrethon.³² Një program i këtij niveli, do të ishte i rekomanduar të hartohet dhe të zbatohet për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Kosovës.

Vizitat e profesionistëve në shkollat e Komunës së Istogut

Komuna e Istogut përfshihet në territorin e fushëveprimit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore të Pejës, e cila vepron në qytetin e Pejës.

Në këtë qendër veprojnë profesionistë nga fushat e ndryshme të trashëgimisë kulturore, përfshirë historianë, arkitektë, etnologë dhe muzeologë.

Përvoja dhe njohuritë e tyre, mund të prezantohen në trajtë të ligjeratave që mund të organizohen në shkollat e Komunës së Istogut.

Nëpërmjet ligjeratave të tilla, nxënësit do të kenë mundësi të njoftohen me profesionistë të fushave të trashëgimisë kulturore, të njihen me vlerat dhe monumentet e trashëgimisë nga territori i Komunave të Pejës, Deçanit, Junikut, Klinës dhe Istogut, dhe me sfidat dhe përparësitë e punës në këtë fushë.

Ligjerata të tilla janë të përshtatshme të mbahen sidomos për nxënësit e klasave të nënta, dhe për nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta, ngase krahas njohurisë praktike për fushën e trashëgimisë kulturore, takimi me profesionistë, do të ndihmonte në zgjedhjen e profesionit për nxënësit e shkollave të mesme të larta.

Ky projekt mund të realizohet me iniciativë të Drejtorisë Komunale të Arsimit, dhe me bashkëpunim të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Pejë.

³² Historic England, Shkollat e Trashëgimisë, <https://historicengland.org.uk/services-skills/education/heritage-schools/how-programme-operates/>, qasur Qershor 2020.

6. Vizitat studimore

Organizimi i vizitave si aktivitete jashtë shkollore është i rregulluar nëpërmjet Udhëzuesit Administrativ, ku zhvillimi i një teme të caktuar në kuadër të kurrikulës mësimore, mund të zhvillohet nëpërmjet një vizite në një lokacion të caktuar.

Vizitat studimore paraqesin si mjet ndihmës për arritjen e njohurive, që nuk mund të elaborohen apo demostrohen në objektet shkollore.

Me qëllim të trajtimit të një teme të caktuar, mësimdhënësit paraprakisht mund të ftojnë në klasë, prindër të profesioneve të ndryshme, përfaqësues të institucioneve publike, me të cilët mund të diskutohet dhe të trajtohet tema. Pas prezantimit dhe shqyrtimit të temës, mund të organizohet vizita në një vend që ndërlidhet me temën e trajtuar, në mënyrë që të demostrohet në praktikë, ajo që është trajtuar në teori.

Në rastin e temave që ndërlidhen me trashëgiminë kulturore, duke u bazuar në kurrikulën mësimore, këto tema krahas prezantimit dhe elaborimit në klasë, rekomandohet që të shoqërohen me vizita në vende. Një nga karakteristikat më interesante të edukimit mbi trashëgiminë kulturore është mundësia që ofrohet që nxënësit të dalin jashtë klasës për të vizituar vende të ndryshme, duke krijuar një përjetim të paharrueshëm si për nxënësit ashtu edhe për mësimdhënësit.

Në vijim do të paraqiten disa itinerare të vizitave jashtë shkollës, për tri kategori mësimore, të cilët mund të aplikohen nga shkollat në komunën e Istogut.

6.1. Vizitë në qytetin / fshatin tënd

Komuna e Istogut është një vend shumë i pasur me monumente të trashëgimisë kulturore, materiale dhe jomateriale.

Për nxënësit e shkollave fillore, respektivisht klasët 1-5, mund të organizohen vizita të shkurta, në kuadër të orarit mësimor në monumente që gjenden në qytetin / fshatin ku gjendet shkolla.

- Përzgjedhja e temës dhe trajtimi në kuadër të orarit mësimor

Nga fusha Shoqëria dhe Mjedisi, koncepti: Proceset shoqërore dhe natyrore, ku përfshihet trajtimi i temave të ndryshme të cilët kanë për qëllim identifikimin e elementeve të trashëgimisë në vendin ku jetojnë, psh. Ndërtesa arkitektonike, veshje, ushqime, rite e zakone.³³ Ndryshimet pozitive dhe negative si rrjedhojë e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, sikurse punimi i tokës, kultivimi i drithërave, dhe ndikimi i këtyre ndryshimeve në cilësinë e jetës. Në kuadër të këtij koncepti, tema elaborohet nga mësimdhënësi, në përputhje me udhëzimet e kurrikulës mësimore.

³³ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Kurrikulat Lëndore / Programet mësimore (Klasa e dytë)*, <https://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>, qasur Qershor 2020.

- Përzgjedhja e vendit që do të vizitohet

Krahas elaborimit të temës së përzgjedhur, mësime dhënësit inkurajohen të gjejnë vende potenciale të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale, që gjenden në qytetin apo fshatin e tyre.

Në komunën e Istogut, në fshatrat ku gjenden shkollat fillore, ekzistojnë edhe monumente të trashëgimisë kulturore, sikurse: rasti në fshatin Vrellë ku gjendet shkolla fillore dhe e mesme e ulët, gjenden një numër i konsiderueshëm i monumenteve të trashëgimisë kulturore: Xhamia e Tedelit, Kulla dhe Mulliri i Ali Bel Bicaj, Kulla e Sali Osmon Bicaj, Mulliri dhe Sharra e Qelë Bicaj.



FIGURA 4 KULLA DHE MULLIRI I ALI BEL BICAJ NË VRELLË (BURIMI: MKRS)

Para organizimit të vizitës, në kuadër të orarit mësimor, mësime dhënësi/sja duhet të ofrojë informatat e nevojshme në lidhje me vendin që do të vizitohet.

Pas trajtimit të temës rreth hapësirës së banimit dhe vendndodhjes së tyre, nxënësit mund të vizitojnë një Kullë të shek. XIX për të kuptuar më mirë, se si jetonin njerëzit në të kaluarën, dhe të bëjnë krahasimin me shtëpitë e tyre. Ose vizita mund të realizohet edhe në njërin prej mullirve të fshatit, për të kuptuar më mirë, mënyrën e kultivimit dhe përpunimit të drithërave, duke përdorur energjinë nga natyra, respektivisht ujin.

- Organizimi i vizitës

Vizitat rekomandohet të bëhen gjatë kohës së përshtatshme, kur kushtet atmosferike lejojnë shetitjet në këmbë, dhe qëndrimin në ambient të hapur, në muajt e parë të gjysmëvjetorit dimëror, apo në muajt pranveror – veror, të fundit të gjysmëvjetorit veror.

Në rastin më të mirë, rekomandohet që në vendin e vizituar, nxënësit të priten nga njëri prej familjarëve, të cilët do të ndajnë edhe tregimin e historisë së tyre së bashku me nxënësit.

Në këtë mënyrë, nxënësit nga mosha e hershme do të mësohen të identifikojnë vlerat e vendbanimit të tyre. Gjatë vizitës, duhet të rezervohet edhe koha për reflektim dhe

diskutim, ndërmjet nxënësëve dhe mësimeve, për të bërë një rekapitulim rreth asaj që kanë parë gjatë ditës. Diskutoni me nxënësit rreth atyre çfarë panë dhe mësuan, duke përfshirë ato gjëra që u pëlqyen më shumë apo më pak;

- Reflektimet pas vizitës

Në përfundim të vizitës në vend, si detyrë shtëpie nga nxënësit kërkohet që të bëjnë një vizatim të asaj që kanë parë, dhe që reflekton përshtypjet e tyre nga vizita e realizuar.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth lokacionit të monumenteve të trashëgimisë kulturore në komunën e Istogut, po e paraqesim listën e monumenteve dhe vendndodhjen e tyre.

Monumentet që gjenden në këtë listë nuk janë vetëm si pikënisje dhe nuk përjashtohet mundësia e shtimit të ndonjë ndërtese tjetër me vlerë të trashëgimisë kulturore, që mund të gjendet në vendbanimet e ndryshme të kësaj komune.

Emri i monumentit	Periudha	Lokacioni	Institucion arsimor: SHF; SHMU; SHML
Kulla e Sali Bajram Dreshaj	Shek XIX	Istog	SHF; SHMU; SHML
Kulla e Hasan Rexhë Salihaj	Shek XIX	Istog	SHF; SHMU; SHML
Xhamija e vjetër e Istogut	1730	Istog	SHF; SHMU; SHML
Manastiri i Gorioçit	Mesjetë	Istog	SHF; SHMU; SHML
Tuma në afërsi të Restorant Trofta - Istog	Parahistori	Istog	SHF; SHMU; SHML
Tuma Ilire (Në oborrin e Kishës së Shën Pjetrit dhe Shën Palit)	Parahistori	Istog	SHF; SHMU; SHML
Xhamia në fshatin Kaliqan	Shek. XIX	Kaliqan, Istog	Shkollë fillore
Kulla e Lash Ukaj	Shek. XIX	Kaliqan, Istog	Shkollë fillore
Lokaliteti i periudhës romake në Kaliqan	Romake	Kaliqan, Istog	Shkollë fillore
Shkolla fillore	Shek. XX	Dobrushë, Istog	Paralele e ndarë e SHF
Gërmadhat e Kishës me varre në potesin Voçarë	Mesjetë	Dobrushë, Istog	Paralele e ndarë e SHF

Xhamia e Tedelit	Shek. XIX	Vrellë, Istog	SHF; SHMU
Mulliri i Qelë Bicaj	Shek. XX	Vrellë, Istog	SHF; SHMU
Kulla dhe Mulliri i Ali Bel Bicaj	Shek. XIX	Vrellë, Istog	SHF; SHMU
Kulla e Sali Osmon Bicaj	Shek. XIX	Vrellë, Istog	SHF; SHMU
Sharra e Qelë Bicaj*	Shek. XX	Vrellë, Istog	SHF; SHMU
Manastiri i Virgjëreshës së Shenjtë të Hvosnos	Mesjetë	Vrellë, Istog	SHF; SHMU
Shpella e Hoxhës në Vrellë	Antikë	Vrellë, Istog	SHF; SHMU
Kisha paleokristiane në Vrellë	Antikitet i vonë	Vrellë, Istog	SHF; SHMU
Lokaliteti arkeologjik-Fortesa në Vrellë	Antikitet i vonë	Vrellë, Istog	SHF; SHMU
Kulla e Bashor Pren Gegaj	Shek. XVIII	Gurakoc, Istog	SHF; SHMU
Kulla e Rexhë Fetahut *	Shek. XIX	Gurakoc, Istog	SHF; SHMU
Kisha e Shën Nikollës	Mesjetë	Gurakoc, Istog	SHF; SHMU
Kulla e Qerim Rugovës	Shek. XIX	Llukavci i Begut, Istog	Paralele e ndarë e SHF
Kulla e Zeqir Hakaj	Shek. XIX	Orroberdë, Istog	/
Mulliri i Bekim Binak Kamberaj	Shek. XX	Uqë, Istog	Shkollë fillore
Xhamia e Uqës	Shek. XIX	Uqë, Istog	Shkollë fillore
Banja e Pejës (Ilixha)	Shek. XX	Banjë e Pejës, Istog	SHF; SHMU
Trolli i lindjes së Presidentit Ibrahim Rugova	Shek. XIX - XX	Cercë, Istog	Paralele e ndarë e SHF
Lokaliteti i periudhës romake në Cërcë	Romake	Cercë, Istog	Paralele e ndarë e SHF
Kulla e Haxhi Buleshkaj	Shek. XVIII	Istogu i ultë, Istog	/
Kulla e Xhafer Sylës	Shek. XX	Istogu i ultë, Istog	/
Kulla e Halil Dervish Sylaj	Shek. XIX	Istogu i ultë, Istog	/
Xhamia e Mehmet Akifë Errsojit	Shek. XIX	Shushicë e epërme, Istog	Shkollë fillore
Kulla e Hamdi Halil Osmanaj	Shek. XIX	Trurbohovcit ,Istog	Paralele e ndarë e SHF
Kulla e Tahir Isuf Osmanaj	Shek. XIX	Trurbohovcit ,Istog	Paralele e ndarë e SHF
Xhamia e Trurbohovcit		Turbuhovc ,Istog	Paralele e ndarë e SHF

Xhamia e Studenicës		Studenicë, Istog	Paralele e ndarë e SHF
Mulliri i Mazo Hajdarpashiq	Shek. XX	Carrallukë, Istog	/
Varret e vjetra me lisin shekullor në Carrallukë	Mesjetë	Carrallukë, Istog	/
Kulla e Shaban Turkaj	Shek. XIX	Kashicë, Istog	Paralele e ndarë e SHF
Mulliri i Ibish Arifit	Shek. XX	Muzhevinë, Istog	Paralele e ndarë e SHF
Kulla e Halil Ali Mavraj	Shek. XIX	Saradran, Istog	Shkollë fillore
Kulla e Avdurrahman Ramë Kajtazit	Shek. XIX	Lubovë, Istog	/
Kulla e Nimon Bardh Shatrit	Shek. XIX	Tomoc, Istog	/
Xhamia e Tomocit	Shek. XX	Tomoc, Istog	/
Kulla e Sahit Iberdemaj	Shek. XIX	Lluga, Istog	/
Kisha e Shën Gjonit	Mesjetë	Cërkolez	Shkollë fillore
Gradina në fshatin Cerkolez	Parahistori	Cërkolez	Shkollë fillore
Kishë e antikitetit dhe varrezë mesjetare "Te Qarrat"	Antikë	Cërkolez	Shkollë fillore
Vendbanim parahistorik dhe antik "Arat e Hanit"	Parahistori, Antike	Cërkolez	Shkollë fillore
Lokaliteti i periudhës romake në Cërkolez	Romake	Cërkolez	Shkollë fillore
Ura e gurit ne Zallç	Antikë, Mesjetë	Zallç	Shkollë fillore
Gërmadhat e Manastirit "Hvosna"	Antikë e Vonë, Mesjetë	Studenicë, Istog	/
Gërmadhat e Kishës me varret e vjetra në Belicë	Mesjetë	Belicë, Istog	Paralele e ndarë SHF
Gërmadhat e Kishës paleokristiane në Bajicë	Mesjetë	Bajicë, Istog	Shkollë fillore
Martiriumi paleokristian i Banjicës	Antikë e Vonë	Bajicë, Istog	Shkollë fillore
Quka e Madhe, kështjella antike në Sine	Antikë	Sine, Istog	Paralele e ndarë SHF
Tumat Ilire në Lubozhdë (Nëngurë)	Parahistori	Lubozhdë	Paralele e ndarë SHF

Vendbanim Parahistorik ne Lubozhdë	Parsahistori	Lubozhdë, Istog	Paralele e ndarë SHF
Vendbanimi neolititik në Rakosh	Parahistori	Rakosh, Istog	Shkollë fillore

6.2. Vizitë në Muzeun Arkeologjik dhe monumentet në qytetin e Istogut

Në qytetin e Istogut gjendet Muzeu Arkeologjik, i cili vepron në kuadër të Shtëpisë së Kulturës.

Për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta, respektivisht klasët 6-9, duke mos anashkaluar edhe mundësinë e përfshirjes së Klasave të pesta, rekomandohet të organizohen vizita të shkurtëra, në institucionet kulturore dhe monumente të trashëgimisë kulturore, të cilët gjenden në qytetin e Istogut. Njohja e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe e kulturës në përgjithësi duhet të filloj, fillimisht nga njohja e qytetit ku jetojnë, duke e zgjeruar njohurinë më pas edhe në vende tjera, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.

- Përzgjedhja e temës dhe trajtimi në kuadër të orarit mësimor

Nga fusha Shoqëria dhe Mjedisi, koncepti: Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore, ku përfshihet trajtimi i temave të ndryshme të cilët kanë për qëllim identifikimin e filleve të njerëzimit, veçoritë e periudhave historike, identifikimin e lokaliteteve arkeologjike.³⁴ Gjithashtu në kuadër të Konceptit: Proceset shoqërore dhe natyrore, ku përfshihet trajtimi i temave që kanë të bëjnë me identifikim të qytetërimeve nga periudhat e lashta, antike, ilire, romake, e mesjetare, të rilindjes e deri në ditët e sotme.

Në kuadër të këtij koncepti, tema elaborohet nga mësimdhënësi, në përputhje me udhëzimet e kurrikulës mësimore.

- Përzgjedhja e vendit që do të vizitohet

Krahas elaborimit të temës së përzgjedhur, mësimdhënësit inkurajohen të krijojnë kontakte me përfaqësues të institucioneve kulturore, sikurse Shtëpia e Kulturës dhe Muzeu Arkeologjik komunal.

Në qytetin e Istogut vepron Muzeu Arkeologjik me një fond të pasur të eksponateve arkeologjike nga ky territor. Krahas Muzeut Arkeologjik, në qytet gjenden edhe Xhamia e vjetër, e cila daton nga shek. XVIII, dy Kullat të gurit nga shek. XIX dhe një Manastir nga Mesjeta.

³⁴ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Kurrikulat Lëndore / Programet mësimore (Klasa e gjashtë)*, <https://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>, qasur Qershor 2020.

Pas trajtimit të temave në përputhje me kurrikulën mësimore, mund të realizohen vizita, njëra në Muzeun Arkeologjik komunal dhe vizita e dytë në Kullat e gurit si dhe në Xhaminë e vjetër të Istogut.

- Organizimi i vizitës

Vizitat rekomandohet të bëhen gjatë kohës së përshtatshme, kur kushtet atmosferike lejojnë shetitjet në këmbë, dhe qëndrimin në ambient të hapur, në muajt e parë të gjysëmvjetorit dimëror, apo në muajt pranveror – veror, të fundit të gjysëmvjetorit veror.

Para vizitës në Muzeun Arkeologjik, rekomandohet kontaktimi i përgjegjësit të muzeut apo edhe udhërrëfyesit / guidës, dhe pritja e nxënësve nga ana e tij.

Në këtë mënyrë, njohuritë e prezantuara rreth periudhave historike, respektivisht të lashta e antike, do të demonstrohen nëpërmjet prezantimit të artefakteve nga këto periudha, të cilët janë gjetur në territorin e komunës së Istogut.

Kjo do të ndihmojë në kuptimin më praktik të mënyrës së punimit të veglave dhe mjeteve gjatë periudhave historike, duke e rritur edhe ndjenjën e përkatësisë, ngase këto artefakte janë zbuluar në territorin ku jetojnë nxënësit, mbase mund t'u përkisnin paraardhësve të tyre.

Para vizitës në muze, për çdo nxënës mund të caktohet një objekt të cilin ata duhet ta vëzhgojnë dhe ta studiojnë në imtësi, veçanërisht gjatë vizitës. Nxënësve mund t'u jepet një fletë e aktiviteteve "Kërkim mbi një objekt në muze"³⁵, që nevojitet të plotësohet gjatë dhe pas vizitës në muze. Kjo fletë përmban seksione që duhet të plotësohen nga nxënësit me informata në lidhje me: tiparet fizike të objektit, mënyra e ndërtimit, funksioni, tiparet artistike, dhe vlera. (*Shih Aneksin 1 në fund të Udhëzuesit*)

Gjatë vizitës, duhet të rezervohet edhe koha për reflektim dhe diskutim, ndërmjet nxënësve, mësimdhënësve dhe zyrtarëve të Muzeut Arkeologjik, për të bërë një rekapitulum rreth asaj që kanë parë gjatë ditës.

- Reflektimet pas vizitës

Në përfundim të vizitës në vend, si detyrë shtëpie nga nxënësit kërkohet që të plotësojnë fletën e aktiviteteve "Kërkim mbi një objekt në muze", dhe të përgadisnin një ese të përshtypjeve të krijuara nga vizita.

Krahas eseut, mund të përgaditet edhe një lloj punimi i kombinuar me tekst, vizatim dhe ilustrime.

Për të pasur ndërveprim ndërmjet nxënësve, detyra mund tju ipet grupeve nga dy-tre të nxënësve, të cilët më pas do ta prezantojnë rezultatet e punimit para klasës.

³⁵ UNESCO "Trashëgimia Botërore në duart e të rinjëve", Paris, 2015, faqe 27, <https://whc.unesco.org/en/educationkit/#downloadkit>, qasur Qershor 2020.

6.3. Vizitë në Muzeun Etnologjik dhe Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Pejë

Qyteti i Pejës gjendet rreth 30 km në jugperëndim të Istogut. Në këtë qytet gjendet Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore, i cili është institucion përgjegjës për dokumentimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në rajonin perëndimor të Kosovës, ku përfshihet edhe Komuna e Istogut.

Në qytetin e Pejës gjendet Muzeu Etnologjik, në Konakun e Tahir Beut, i cili paraqet një shembull të dalluar të një shtëpie të vjetër qytetare, nga gjysma së dytë e shek. XVIII. Në këtë muze janë të ekspozuara mbi 120 eksponate të cilët prezantojnë kulturën dhe traditat e këtij vendi, duke mos përjashtuar edhe disa eksponate të kohës Ilire.

Për nxënësit e shkollave të mesme të larta, respektivisht klasët 10-12, rekomandohet të organizohen vizita në qytetin e Pejës, fillimisht në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore dhe më pas në Muzeun Etnologjik të Pejës. Një vizitë e tillë studimore, do të mundësojë njoftimin e nxënësve me profesionistë nga fusha e trashëgimisë kulturore, që veprojnë në një qytet shumë të afërt me qytetin ku jetojnë, dhe zgjerim të njohurive të Muzeve, krahas muzeut komunal që gjendet në qytetin e tyre.

- Përzgjedhja e temës dhe trajtimi në kuadër të orarit mësimor

Në Shkollat e Mesme të Larta, temat që ndërlidhen me trashëgiminë kulturore trajtohen kryesisht në fushën Shoqëria dhe Mjedisi, respektivisht në Lëndët: Edukatë Qytetare dhe Histori. Në kuadër të këtyre lëndëve trajtohen konceptet, të cilët kanë për qëllim kryesor, që përtej identifikimit të proceseve shoqërore dhe historike, të krijojnë edhe mendimin kritik të nxënësit në lidhje me këto tema.

Koncepti: Proceset shoqërore, ku përfshihet trajtimi i temave të ndryshme të cilët kanë për qëllim hulumtimin e monumenteve, dukuritë, proceset historike dhe ndikimet ndërmjet tyre.³⁶ Në kuadër të këtij koncepti, tema elaborohet nga mësimdhënësi, në përputhje me udhëzimet e kurrikulës mësimore.

- Përzgjedhja e vendit që do të vizitohet

Krahas elaborimit të temës së përzgjedhur, mësimdhënësit inkurajohen të krijojnë kontakte me përfaqësues të institucioneve të nivelit qendror, respektivisht me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Pejë.

Me qëllim të realizimit të vizitës jashtë qytetit, nevojitet të zbatohen normativat e paraqitura në Udhëzuesin Administrativ, ku kërkohet aprovimi i kostos financiare nga udhëhëqësitë e drejtorisë komunale dhe aprovimi nga këshilli i prindërve, për organizim të vizitës jashtë territorit të komunës së Istogut.

³⁶ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Kurrikulat Lëndore / Programet mësimore (Klasa e gjashtë)*, <https://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar>, qasur Qershor 2020.

Bashkëpunimi ndërmjet shkollave të mesme të larta të Komunës së Istogut dhe Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Pejë, mund të realizohet nëpërmjet Drejtorisë Komunale të Arsimit, në formë të bashkëpunimit ndër-institucional.

Pas plotësimit të kërkesave administrative, kontaktohen përfaqësuesit e QRTK Pejë, dhe caktohet një orar i përshtatshëm për realizim të vizitës dhe përcaktimi i personave përgjegjës të cilët do t'i presin dhe do t'i shoqërojnë nxënësit gjatë vizitës.

- Organizimi i vizitës

Vizitat rekomandohet të bëhen gjatë kohës së përshtatshme, kur kushtet atmosferike lejojnë shëtitjet në këmbë, dhe qëndrimin në ambient të hapur, në muajt e parë të gjysëmvjetorit dimëror, apo në muajt pranveror – veror, të fundit të gjysëmvjetorit veror.

Nxënësve paraprakisht duhet t'u jepet material për lexim që është relevant për vendin që do të vizitohet, në këtë rast qyteti i Pejës. Nxënësit duhet të parapërgatiten rreth asaj se çfarë do të vizitojnë dhe çka pritet nga ata me rastin e vizitës, në aspektin e grumbullimit të informatave, bërjes së fotografive nga vendi etj. Gjithashtu ju shpjegohet dhe ju shpërndalet Fleta e Aktiviteteve për Nxënësit, që duhet të plotësohet para, gjatë dhe pas vizitës. Kjo fletë përmban seksione të ndryshme ku kërkon angazhimin interaktiv të nxënësit gjatë vizitës (*Shih Aneks 2 në fund të udhëzuesit*)³⁷

Vizita në QRTK Pejë ka për synim njoftimin me fushëveprimin e këtij institucioni, profilet e profesionistëve të cilët punojnë në këtë institucion, kualifikimet profesionale të nevojshme për të punuar në një institucion të trashëgimisë kulturore, dhe përgjegjësitë e tyre.

Një kontakt i drejtpërdrejtë me punëtorët profesional e administrativ nga fusha e trashëgimisë kulturore, do të ndihmonte në orientimin profesional të nxënësve të shkollave të mesme të larta, të cilët së shpejti do të përcaktohen për fushat e studimit në studimet universitare.

Pas vizitës në QRTK Pejë, vizita mund të vazhdojë në Muzen Etnografik të Pejës, ku nxënësit kanë mundësi të vizitojnë një Shtëpi të vjetër qytetare nga shek. XIX, i cili është shndërruar në Muze, dhe është në shërbim të edukimit dhe vetëdijesimit të publikut. Poashtu nxënësit do të mund të vizitonin ekspozitën e përhershme që paraqet motive nga jeta tradicionale e Pejës.

Në këtë mënyrë, nxënësit do të krijojnë një mendim kritik rreth identifikimit të një monamenti të trashëgimisë kulturore, mbrojtjes dhe ruajtjes së saj duke funksionuar me një funksion alternativ, krahas funksionit fillestar.

Gjatë vizitës, duhet të rezervohet edhe koha për reflektim dhe diskutim, ndërmjet nxënësve, mësimeve, dhe përfaqësuesve institucional për të bërë një

³⁷ UNESCO "Trashëgimia Botërore në duart e të rinjve", Paris, 2015, faqe 24-25, <https://whc.unesco.org/en/educationkit/#downloadkit>, qasur Qershor 2020.

rekapitulim rreth asaj që kanë parë gjatë ditës. Një pjesë e kohës mund t'i dedikohet argëtimit, këndimi i ndonjë kënge tradicionale së bashku në oborrin e muzeut, dhe ngrënia e ushqimit të përgaditur parapaprakisht nga prindërit, për tu ndarë edhe me punonjësit e Muzeut.

- Reflektimet pas vizitës

Në përfundim të vizitës në vend, si detyrë shtëpie nga nxënësit kërkohet që të plotësojnë Fletën e Aktiviteteve, dhe përgadisnin nga një prezantim interaktiv, ku kërkohet që secili nxënës të elaborojë:

- Përshtypjet e asaj çka kanë parë dhe mësuar, duke përfshirë aspektet që ju kanë pëlqyer më shumë apo më pak;
- Çfarë domethënie dhe rëndësi kanë vlerat e zbuluara gjatë vizitës, për atë si individ;
- Rëndësia e ruajtjes së trashëgimisë kulturore për gjeneratat e ardhshme;
- Mënyrat e ruajtjes dhe adaptimit të monumenteve;
- Përshtypjet individuale dhe një këndvështrim për të ardhmen.

Punimi mund të përcjellët edhe me informata shtesë rreth qytetit të Pejës, që mund të gjenden nëpërmjet hulumtimit bibliografik dhe shfrytëzimit të internetit.

Inkurajohen nxënësit që në këtë punim të përdorin fotografitë e bëra gjatë vizitës, skicat dhe vizatime, tekstet dhe informata shtesë që mund të marrin nga librat apo interneti, duke krijuar kështu një punim interaktiv ku ngërthehen aftësitë e mendimit kritik, të shkrimit, dhe të arteve.

Punimet prezantohen në klasë, dhe mund të paraqiten në trajtë ekspozite, duke krijuar një mini-aktivitet në kuadër të shkollës.

6.4. Ekskursionet një ditore brenda territorit të Kosovës

Ekskursioni mësimor është formë e veprimtarisë jashtëshkollore e mësim nxënies. Objektivi i ekskursionit mësimor, patjetër duhet të jetë arritja e njohurive të cilat duhen të arrihen, por që nuk mund të demonstrohen në objektet shkollore. Detyrë e ekskursionit mësimor është që nxënësit t'i përcjellin njohuritë elementare nga disa tërësi mësimore-shkencore drejtpërdrejt në hapësirë dhe në këtë mënyrë të arrijnë perceptime të qarta dhe të arrijnë njohuri të përhershme.³⁸

Ekskursionet që kanë të bëjnë me njohjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, ndikojnë drejtpërdrejtë në edukimin dhe vetëdijesimin e nxënësve rreth vlerave dhe rëndësisë së mbrojtjes së tyre.

³⁸ Azizi Ismet, Cili është qëllimi i ekskursionit shkollor dhe si duhet të organizohet ai në *Ekonomia*, <http://www.ekonomia-ks.com/sq/opinion/cili-eshte-qellimi-i-ekskursionit-shkollor-dhe-si-duhet-te-organizohet-ai>, qasur Qershor 2020.

Ekskursionet tematike sipas fushave mësimore supozohet se do të kishin treguar sukses më të madh, pasi që në këto vizita do të merrnin pjesë nxënësit e interesuar në atë fushë.

Krahas ekskursioneve të organizuara në kuadër të kurrikulës mësimore, të cilat nuk mund të merren si shembuj pozitiv në këtë aspekt, gjatë viteve janë organizuar vizita tematike, respektivisht me temë: Njohja e Trashëgimisë Kulturore, nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile.

Në vijim do të elaborohet itinerari i vizitave "Hajde", të organizuara gjatë viteve 2013-2014 në kuadër të programit "Promovimi i diversitetit kulturor të Kosovës", financuar nga Këshilli i Europës.

- Përzgjedhja e vendit që do të vizitohet

Vizitat tematike edukative rekomandohet të organizohen për nxënësit e shkollave të mesme të larta, klasat 10-12. Këto vizita tematike duhet të udhëhiqen dhe të organizohen nga Mësimdhënësit e Fushës: Shoqëria dhe Mjedisi, respektivisht nga Profesorët e lëndës Edukatë Qytetare, Histori, të shoqëruar edhe nga mësimdhënës tjerë, sikurse nga fusha e Artit. Rekomandohet që në këto vizita të ftohen edhe përfaqësuesit e këshillit të prindërve dhe prindër tjerë të interesuar.

Mësimdhënësit fillimisht duhet të përpilojnë itinerarin / programin e vizitës, ku zgjedhen vizitat në disa nga monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore. Ata mund të zgjedhin njërin nga itineraret e propozuara më poshtë.

Me qëllim të realizimit të vizitës jashtë qytetit, nevojitet të zbatohen normativat e paraqitura në Udhëzuesin Administrativ, ku kërkohet aprovimi i kostos financiare nga udhëhëqësitë e drejtorisë komunale dhe aprovimi nga këshilli i prindërve, për organizim të vizitës jashtë territorit të komunës së Istogut.

Pas aprovimit të itinerarit, rekomandohet krijimi i kontaktit me përfaqësues të institucioneve të trashëgimisë kulturore, të cilët janë përgjegjës për monumentet që do të vizitohen. Qëllimi i krijimit të një kontakti paraprak, është që përfaqësuesit institucional, të përcaktojnë një profesionist përgjegjës, i cili do t'i pret në vendin e vizituar, dhe to t'u ofrojë informata në lidhje me monumentin.

Bashkëpunimi ndërmjet shkollave të mesme të larta të Komunës së Istogut dhe Qendrave Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, mund të realizohet nëpërmjet Drejtorisë Komunale të Arsimit, në formë të bashkëpunimit ndër institucional. Në mënyrë alternative, Komuna e Istogut mund të bashkëpunojë me ndonjë OJQ që trashëgiminë kulturore e ka fushëveprimtari dhe në mënyrë që të lehtësohej organizimi i vizitës.

- Organizimi i vizitës

Vizitat rekomandohet të bëhen gjatë kohës së përshtatshme, kur kushtet atmosferike lejojnë shetitjet në këmbë, dhe qëndrimin në ambient të hapur, në muajt e parë të

gjysëmvjetorit dimëror, apo në muajt pranveror – veror, të fundit të gjysëmvjetorit veror.

Nxënësve parapakisht duhet t'u jepet material për lexim që është relevant për vendin që do të vizitohet, në këtë rast monumentet e trashëgimisë kulturore të përzgjedhura për vizitë.

Nxënësit duhet të parapërgatiten rreth asaj se çfarë do të vizitojnë dhe çka pritët nga ata me rastin e vizitës, në aspektin e grumbullimit të informatave, bërjes së fotografive nga vendi etj. Gjithashtu ju shpjegohet dhe ju shpërndahet Fleta e Aktiviteteve për Nxënësit, që duhet të plotësohet para, gjatë dhe pas vizitës. Kjo fletë përmban seksione të ndryshme ku kërkon angazhimin interaktiv të nxënësit gjatë vizitës. (*Shih Aneks 2 në fund të udhëzuesit*)³⁹

Gjatë vizitës, duhet të rezervohet edhe koha për reflektim dhe diskutim, ndërmjet nxënësve, mësimeve, dhe përfaqësuesve institucional për të bërë një rekapitulum rreth asaj që kanë parë gjatë ditës. Si dhe një pjesë e kohës i dedikohet argëtimit, këndimi i ndonjë kënge së bashku dhe ngrënia e ushqimit të përgaditur parapakisht nga prindërit.

- Reflektimet pas vizitës

Në përfundim të vizitës në vend, si detyrë shtëpie nga nxënësit kërkohet që të plotësojnë Fletën e Aktiviteteve, dhe përgadisnin nga një prezantim interaktiv, ku kërkohet që secili nxënës të elaborojë:

- Përshtypjet e asaj çka kanë parë dhe mësuar, duke përfshirë aspektet që ju kanë pëlqyer më shumë apo më pak;
- Çfarë domethënie dhe rëndësi kanë vlerat e zbuluara gjatë vizitës, për atë si individ;
- Rëndësia e ruajtjes së trashëgimisë kulturore për gjeneratat e ardhshme;
- Mënyrat e ruajtjes dhe adaptimit të monumenteve;
- Përshtypjet individuale dhe një këndvështrim për të ardhmen.

Punimi mund të përcjellet edhe me informata shtesë rreth qytetit ku gjendet monumenti, që mund të gjenden nëpërmjet hulumtimit bibliografik dhe shfrytëzimit të internetit.

Inkurajohen nxënësit që në këtë punim të përdorin fotografitë e bëra gjatë vizitës, skicat dhe vizatime, tekstet dhe informata shtesë që mund të marrin nga librat apo interneti, duke krijuar kështu një punim interaktiv ku ngërthehen aftësitë e mendimit kritik, të shkrimit, dhe të arteve.

Punimet prezantohen në klasë, dhe mund të paraqiten në trajtë ekspozite, duke krijuar një mini-aktivitet në kuadër të shkollës.

³⁹ UNESCO "Trashëgimia Botërore në duart e të rinjëve", Paris, 2015, faqe 24-25, <https://whc.unesco.org/en/educationkit/#downloadkit>, qasur Qershor 2020.

Në vijim po japim itineraret e propozuara të ekskursionit tematik edukativ “Njohja e vlerave të trashëgimisë kulturore të Kosovës” të financuar nga Këshilli i Europës dhe implementuar nga organizata EC Ma Ndryshe, gjatë viteve 2013-2014.

Propozimi 1.1: Trashëgimia kulturore në pjesën perëndimore të Kosovës

- Vizitë te z. Gjon Gjergji - skulptor dhe poet në fshatin Krushevë e Vogël (Klinë);
- Vizitë te znj. Nife Lataj dhe Safete Gacaferri – artizane e veshjeve tradicionale në fshatin Carrabreg (Deçan). Gjatë vizitës, përpos shpjegimeve për këto artizanate, nxënësit kanë rastin të provojnë shkathtësitë e tyre në këto artizanate.
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Deçan: lagjen historike të fshatit Drenoc, kullën e familjes Mazrekaj dhe Manastirin e Deçanit.
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Pejë: Çarshia e vjetër e qytetit, Mulliri i Haxhi Zekës dhe Bajrakli Xhamia.

Propozimi 1.2: Trashëgimia kulturore në pjesën perëndimore të Kosovës

- Vizitë në punëtorinë artizanale të poçarisë së z. Luan Çukanit në Gjakovë. Gjatë vizitës, përpos shpjegimeve për këto artizanate, nxënësit kanë rastin të provojnë shkathtësitë e tyre në këto artizanate.
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Gjakovë: Xhamia e Hadumit, Çarshia e vjetër, Muzeu Etnografik, Ura e Terzive dhe Ura e Tabakëve.
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Deçan: lagjen historike të fshatit Drenoc, kullën e familjes Mazrekaj dhe Manastirin e Deçanit.

Propozimi 2.1: Trashëgimia kulturore në pjesën jugore të Kosovës

- Vizitë në Punëtorinë e Filigranit në Prizren. Gjatë vizitave, përpos shpjegimeve për këto artizanate, nxënësit kanë rastin të provojnë shkathtësitë e tyre në këto artizanate.
- Vizitë në qytetin e Prizrenit dhe disa nga monumentet kryesore të trashëgimisë kulturore materiale dhe asaj natyrore në këtë qytet, si: Xhamia Namazxhah, Kisha Ortodokse e Shën Gjergjit, Xhamia e Sinan Pashës, Sheshi i Shadërvanit, Kompleksi i Marashit dhe Hamami i Gazi Mehmet Pashës.

Propozimi 2.2: Trashëgimia kulturore në pjesën jugore të Kosovës

- Vizitë në artizanen e pikturimit të fytyrës znj. Aziza Sherifagiq në fshatin Lubinje të Poshtme në Prizren. Gjatë vizitave, përpos shpjegimeve për këto artizanate, nxënësit kanë rastin të provojnë shkathtësitë e tyre në këto artizanate.
- Vizitë në qytetin e Prizrenit dhe disa nga monumentet kryesore të trashëgimisë kulturore të këtij qyteti, si: Kisha e Shën Premtes, Xhamia e Sinan Pashës, Sheshi i Shadërvanit, shtëpia e Musa Shehzades, teqja Halveti.

Propozimi 3.1: Trashëgimia kulturore në pjesën qendrore të Kosovës

- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Prishtinë: Sahatkulla, Hamamin e Madhë, Xhaminë e Fatih Sulltanit dhe Muzeun e Kosovës;
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Vushtrri: Kalanë, Hamamin dhe Urën e Gurit.

Propozimi 3.2: Trashëgimia kulturore në pjesën qendrore të Kosovës

- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Prishtinë: Sahatkulla, Hamamin e Madhë, Xhaminë e Fatih Sulltanit dhe Muzeun e Kosovës;
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Obiliq: Tyrbeja e Sulltan Muratit dhe muzeu i tyrbes;
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Fushë Kosovë: Lokaliteti arkeologjik i Harilaçit.

Propozimi 3.3: Trashëgimia kulturore në pjesën qendrore të Kosovës

- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Graçanicë: lokalitetin arkeologjik Ulpiana dhe Manastirin e Graçanicës;
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Prishtinë: Sahatkullën, Hamamin, Muzeun e Kosovës dhe Xhaminë e Madhe.

Propozimi 4.1: Trashëgimia kulturore në pjesën veriore të Kosovës

- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Mitrovicë: Kullën e Isë Boletinit (fshati Boletin), Muzeun Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve (fshati Stantërg), Bazilikën e Shën Pjetrit dhe Xhaminë e Trepçës (fshati Mazhiq) dhe Muzeun e Qytetit të Mitrovicës.
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Vushtrri: Kalanë, Hamamin dhe Urën e Gurit.

Propozimi 4.2: Trashëgimi kulturore në pjesën veriore të Kosovës

- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Mitrovicë: Manastirin e Sokolicës dhe kullën e Isë Boletinit në fshatin Boletin, Muzeun e Qytetit të Mitrovicës, Hamamin dhe disa shembuj të shtëpive tradicionale.
- Vizitë në disa nga lokalitetet kryesore të trashëgimisë kulturore në Vushtrri: Kalanë, Hamamin dhe Urën e Gurit.



**FIGURA 5 PAMJE NGA VIZITAT 'HAJDE'NË LOKALITETE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
(BURIMI: EC MA NDRYSHE)**

7. Ekspozitat (Artet e bukura, fotografia dhe format tjera artistike)

Duke u nisur nga synimet dhe rezultatet e të nxënës të paraqitura në Kurrikulën Mësimore, roli i lëndës së Artit Figurativ në edukimin dhe ngritjen e vetëdijes rreth vlerave të trashëgimisë kulturore tek nxënësit është shumë i madh. Nëpërmjet vizuelizimit të fenomeneve arrihet nxitja e kreativitetit, imagjinatës dhe mendimit kritik të nxënësit.

Shembuj të ndryshëm të trajtimit të Artit Figurativ për edukim dhe ngritje të vetëdijes në fushën e trashëgimisë kulturore mund të hasen edhe në Kosovë.

Organizata Jo-qeveritare Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB Kosova) në kuadër të projekteve të revitalizimit dhe interpretimit të Kalasë së Vushtrrisë, dhe të Kalasë së Prizrenit, kanë trajtuar komponentën e interpretimit dhe edukimit ku në bashkëpunim me pedagogë, artist, dhe nxënës janë përgaditur librat e ilustruar me motive nga lokalitetet e trashëgimisë kulturore.

Librat e Ilustruar: Trashëgimia Kulturore Vushtrri⁴⁰ dhe Kalaja e Prizrenit përmbajnë Ilustrime të lokalitetit, lojë të ndryshme, interpretime të gjetjeve arkeologjike, dhe tekst argëtues për fëmijët. Duke ngjyrosur dhe ilustruar shembujt, fëmijët nëpërmjet argëtimit do të zhvillojnë njohuritë në lidhje me vlerat e trashëgimisë kulturore të një lokaliteti të caktuar.




FIGURA 6 LIBRI I ILUSTRUAR TRASHËGIMIA KULTURORE VUSHTRRI (BURIMI: CHWB KOSOVA)

⁴⁰ CHWB Kosova, *Trashëgimia Kulturore Vushtrri*, Prishtinë, 2015, <http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2015/11/Trashegimia-Kulturore-Vushtrri.pdf>, qasur Qershor 2020.

Përfshirja e temës së trashëgimisë kulturore në interpretimin e artit bashkëkohor është një qasje e cila është shfrytëzuar nga OJQ Autostrada Biennale në Prizren. Kjo organizatë në kuadër të organizimit të Bienales së Artit Bashkëkohor, ka përfshirë edhe komponentën e edukimit me ç'rast janë organizuar një seri aktivitete: - Punëtori me fëmijë – dizajnimi i objekteve të ndryshme të trashëgimisë dhe interpretimi artistik i tyre; - Vizitat e organizuara me nxënës dhe mësime të shkollave fillore në monumentet kryesore të Prizrenit; - Debate me të rinjtë e shkollave të mesme të larta – me qëllim diskutimi kritik dhe reflektimi mbi veprat e artisteve, aspektin social të secilës vepër dhe mesazhin që ato kanë përcjell, dhe kontekstin në kontekstin e hapësirave në të cilat janë vendosur veprat; - **Dizajnimi i librit me ilustrime për fëmijë** - janë paraqitur objektet e trashëgimisë kulturore përmes pikave dhe numrave, fëmijët i kanë bashkuar pikat dhe kanë arritur të objekti final; dhe – Organizimi i Ditëve Familjare – ku prindërit janë inkurajuar të vizitojnë ekspozitat dhe të marrin pjesë në programin e edukimit së bashku me fëmijët e tyre.

Një iniciativë e ngjashme mund të bëhet edhe në shkollat e Komunës së Istogut, ku aktivitetet e vizitave edukative (të elaboruara në pikat e mësimeve) mund të zhvillohen si aktivitetet ndër kurrikulare, me pjesëmarrje të mësimeve nga fusha: Shoqëria dhe Mjedis, dhe Artet në këto vizita.

Përfshirjet nga vizitat në monumente të trashëgimisë kulturore dhe muze, mund të elaborohen më tej në formë të punimeve artistike në përputhje me kurrikulën mësimore për secilën klasë.

Librat e Ilustruara në lidhje me lokalitetet e trashëgimisë kulturore të Vushtrrisë, dhe të Prizrenit janë publikime që mund të shkarkohen dhe të shfrytëzohen edhe në shkollat e Komunës së Istogut. Në këtë mënyrë nxënësit do të zgjerojnë njohuritë e tyre edhe në monumentet e trashëgimisë kulturore përtej vendbanimit të tyre.

Punimet artistike të punuara si rezultat i ligjerimit në orë mësimore, dhe vizitat shtesore, mund të prezantohen për nxënësit e shkollës dhe prindërit në formë të organizimit të një ekspozite për të shënuar përfundimin e vitit shkollor ose për të shënuar ndonjë datë të rëndësishme, sikurse Dita e Shkollës, apo Shënimi i Ditës Nërkombëtare të Monumenteve.

Organizimi dhe prezantimi i ekspozitës së punimeve të nxënësve do të ndihmojë në zbatimin e njohurive dhe përvojave të fituara, me rast të vizitave të organizuara, duke e ndërruar rolin e nxënësve në këtë rast, pasi që vizitorë do të jenë nxënësit tjerë dhe prindërit.

8. Lojërat – Edukimi përmes argëtimit

Në kuadër të aktiviteteve jashtë kurrikulare përfshihen edhe Lojërat e ndryshme që do të ndihmonin në edukimin përmes argëtimit. Aktivitetet e lira plotësojnë një gamë më të gjerë të nevojave dhe qëllimeve të parapara të realizohen nëpërmjet programit mësimor:

- Thyerja e barrierave dhe njohja më e mirë e nxënësve ndërmjet veti;
- Ndërtimi i ekipit dhe punës në grup;
- Stimulimi i diskutimit për tema nganjëherë abstrakte dhe të komplikuar, në një mjedis të relaksuar;
- Inkurajimi i vrojtimit, dëgjimit të mendimeve të tjerëve nëpërmjet sesionit të pyetjeve dhe përgjigjeve;
- Këmbimi i njohurive dhe përvojave të ndryshme; dhe
- Kalimi nga teoria në praktikë;

Aktivitete të lira të natyrave të ndryshme mund të konceptohen dhe të hartohen me iniciativë të mësimeve, dhe të organizohen me rastin e shënimit të ditëve të rëndësishme qoftë për shkollën, qytetin/fshatin apo vendin në përgjithësi. P.sh. me rastin e shënimit të Ditës së Shkollës, apo të ndonjë feste zyrtare, mund të organizohen aktivitetet argëtuese dhe edukuese, që theksojnë edukimin mbi vlerat e trashëgimisë kulturore në veçanti.

Në vijim do të elaborohen disa aktivitete të lira:

8.1. Kuizi i Trashëgimisë Kulturore

Në projektin e trashëgimisë kulturore i cili është zbatuar nga GUIDEKS (Asociacioni i guidave turistike të Kosovës) në vitin 2019 është realizuar në format të një kuizi të diturisë ku janë ftuar të gjitha shkollat e mesme të ulëta (klasat VI, VII, VIII dhe IX) dhe mesme të larta (klasat X, XI dhe XII) të Komunës së Prizrenit dhe Gjakovës. I njëjti projekt është pilotuar në vitin 2015 edhe në Komunë të Vushtrrisë nga CHwB Kosova.

Ky projekt synon që përmes garës të rrisë kërshërinë dhe kreativitetin e të rinjve sa i përket trashëgimisë kulturore jo vetëm të Kosovës por edhe të rajonit dhe botës. Gara pos nxënësve në mënyrë aktive përfshin edhe arsimtarët përgjegjës që punojnë në përgaditjen e nxënësve të tyre por edhe të prindërve që përcjellin aktivitetet e projektit. Lokacioni i garave preferohet të mbahet në ndonjë monument, sikurse që janë mbajtur në Hamamin e Prizrenit apo Kullën e Abdullah Pashë Drenit dhe Muzeun Etnografik në Gjakovë.

Në projekt, pasi që shkollat kanë përzgjedhur ekipet e tyre me nga 4 nxënës përfaqësues, stafi i projektit ka shpërndarë literaturën e nevojshme që nxënësit të përgaditen për garë. Literatura përmbante publikime të ndryshme të shtypura apo dixhitale me informata mbi trashëgiminë lokale, kombëtare dhe asaj botërore

Fillimisht të gjitha shkollat e ftuara kanë hyrë në një test kualifikues ku më pas në bazë të renditjes së arritjes në teste, janë kualifikuar nga 8 shkolla për çdo komunë. Këto 8 shkolla të kualifikuara kanë garuar në çerekfinale. Fituesit e çerekfinales kanë kaluar në garën gjysmëfinale dhe në fund fare në finale të garës. Gjatë garës nxënësit janë ballafaquar pyetje të tipit: pyetje me përgjigje me disa opsione, me përgjigje të drejtpërdrejta apo edhe ato me fotografi. Pjesë e kuizit ishin edhe lojërat e ndryshme sikurse mozaiku i trashëgimisë kulturore e natyrore të Kosovës dhe ajo e memories.

Në fund të kuizit ekipet e shkollave fituese, katër shkollat më të suksesshme përpos njohurive që kanë fituar janë shpërblyer edhe me dhurata simbolike.



FIGURA 7 PAMJE NGA KUIZI I TRASHËGIMISË KULTURORE (BURIMI: GUIDEKS)

Një përvojë e ngjashme mund të aplikohet edhe në shkollat e Komunës së Istogut, ku mund të marrin pjesë Shkollat e Mesme të Ulëta dhe Shkollat e Mesme të Larta. Në mënyrë që kjo metodologji të mund të përdoret, Komuna mund të kërkojë bashkëpunim OJQ GUIDEKS, të cilët tashmë kanë zbatuar një metodologji të tillë.

Gjithashtu nuk përjashtohet mundësia e vetë inicitativës së Komunës së Istogut, nëpërmjet Drejtorisë komunale për Arsim, të cilët mund të themelojnë një Grup punues të përbërë nga mësimdhënësit e fushës Shqipëria dhe Mjedis, të cilët do të përgadisin përmbajtjen e kuizit, dhe të organizojnë në nivel të komunës.

8.2. E ka Kush e Ka

Ky projekt është hartuar nga OJQ CHwB Shqipëria⁴¹ me emërtimin e Koleksionit " E Ka Kush e Ka", i cili synon që nëpërmjet një seri libërthash dhe lojërash të përfshijë fëmijë dhe të rritur në zbulimin dhe rizbulimin e trashëgimisë kulturore si një urë lidhëse me botën që na rrethon.

⁴¹ CHwB Albania, *Mos u nxeh - Gjirokastra*, Tiranë, 2017, <http://chwb.org/albania/wp-content/uploads/sites/4/2017/10/Versioni-online-i-thjeshte.pdf>, qasur Qershor 2020.

Trashëgimia kulturore nuk është thjesht një njohuri që duhet mësuar, por edhe një mbështetje edukative dhe argëtuese në shërbim të njohjes dhe zbulimit të së resë, të tjetrit, të shoqërisë sonë.

Koleksioni shërben dhe si mbështetje praktike për organizimin e Atelieve të Trashëgimisë, aktivitete argëtuese përfshirëse për fëmijë të organizuara së bashku me institucione arsimore, muze dhe site të ndryshme në Shqipëri. Ky koleksion përfshin 6 libërtha me ilustrim dhe ngjyrosje, 1 puzzle, 1 model prej letre të një monumenti për të ndërtuar vetë, dhe 5 libërtha me lojën “mos u nxeh”.



FIGURA 8 SERIA E BOTIMEVE “E KA KUSH E KA” (BURIMI: CHWB ALBANIA)

Disa nga këto libërtha janë të hapur për shfrytëzim të publikut, dhe mund të ngarkohen nga ueb faqja e kësaj organizate: <http://chwb.org/albania/activities/koleksioni-per-femije-e-ka-kush-e-ka/?lang=sq>

Këta shembuj mund të shkarkohen të shtypen dhe të përgaditen për tu përdorur në kuadër të mësimin edhe në shkollat e komunës së Istogut, në kuadër të Lëndës: Artet Figurative.

Aktivitetet e paraqitura janë të përshtatshme për të gjithë nxënësit e Arsimit fillor dhe të Mesëm të Ulët, pra klasat 1-5 dhe 6-9.

Në kuadër të kësaj serie është krijuar edhe loja “Mos u nxeh” me seri në qytete të ndryshme në Shqipëri dhe atë në format të madh 6x6 metra por edhe në version të lojës në tavolinë.



**FIGURA 9 SERIA E LOJËS “MOS U NXEH” NË DY VERZIONE: NË KLASË DHE NË NATYRË
(BURIMI: CHWB ALBANIA)**

8.3. Përjetimi i historisë nëpërmjet dramatizimit në vendet e Trashëgimisë kulturore

Një metodë efektive dhe e dobishme për të nxitur interesin e nxënësve për fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është Drama. Loja me role ka pesë objektiva kryesore:⁴²

- ✓ Rritja e ndërgjegjësimi;
- ✓ Temat e vështira dhe abstrakte bëhen të kuptueshme;
- ✓ Nxënësit fitojnë aftësi kërkimore dhe hulumtuese;
- ✓ Ndhmon në formësim të këndvështrimeve;
- ✓ Zhvillon potencialin kreativ të nxënësit.

Fusha e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore përfshin shumë çështje sfiduese, e ndonjëherë edhe të ndërlikuara për t'u kuptuar nga nxënësit e moshave të ndryshme. Dokumentimi, propozimi në mbrojtje, mënyra e përzgjedhjes së materialeve për mbrojtje, planifikimi i ruajtjes dhe zhvillimit, turizmi kulturor, janë disa nga fushat komplekse që duhet t'u përcjellen si njohuri për nxënësit.

Sipas moshës së nxënësve, mësimdhënësit mund të përdorin aktivitete - drama për t'i ndihmuar ata të zbulojnë trashëgiminë e tyre kulturore. Nëpërmjet Dramës / Shfaqjes teatrale, nxënësit mund të kuptojnë më mirë çështje të tilla, si dhe të krijojnë këndvështrime për zgjidhje të problemeve.

Aktiviteti i mëposhtëm është i përshtatshëm për t'u përdorur për nxënësit e Shkollave fillore dhe të mesme të ulëta (Klasat 3-5 dhe 6-9)

⁴² UNESCO “Trashëgimia Botërore në duart e të rinjve”, Paris, 2015, faqe 29-30, <https://whc.unesco.org/en/educationkit/#downloadkit>, qasur Qershor 2020.

Kërkojuni nxënësve tuaj të mendojnë për traditat e rajonit ose të vendit të tyre dhe t'i shkruajnë ato. Nxënësit duhet të gjejnë informacione si fotografitë dhe videot dhe t'i ndajnë me shokët e tyre të klasës, për t'u përgaditur një prezantim i përbashkët.⁴³

Kolegët tuaj bëjnë të njëjtën gjë me nxënësit e tyre, e paraleles së njëjtë.

Çdo klasë partnere duhet të zgjedhë një traditë e cila paraqitet para klasave tjera. Pas prezantimit, nxënësit votojnë dhe zgjedhet prezantimi (tradita më e votuar). Prezantimi i zgjedhur, duke përdorur edhe informacionet e përbashkëta, përgaditet të vihet në skenë në formë të dramës. E cila prezantohet para të gjithë klasave dhe shkollës.

Për nxënësit më të mëdhenj (Klasat 7-9), ata gjithashtu mund të diskutojnë dhe identifikojnë nëse traditat e tyre kanë aspekte të përbashkëta.

Aktiviteti i mëposhtëm është i përshtatshëm për tu përdorur për nxënësit e Shkollave të mesme të larta (Klasat 10-12)

Mësuesit mund ta ndajnë klasën në grupe të vogla dhe mund t'i kërkojnë çdo grupi të reflektojë dhe të kërkojë pozicionin e grupit ose personit të cilin ata duhet të luajnë.⁴⁴ Mësuesit mund t'i ndihmojnë duke u sugjeruar ku mund të gjejnë informacionet e përshtatshme. Nga ana tjetër, mësuesit mund të përgatisin përpara klasës fletë me profilet e çdo pale të interesuar dhe t'i shpërndajnë ato mes grupeve të nxënësve. Çdo grup diskuton pozicionin e tij dhe përzgjedh një nxënës për të marrë pjesë në inskenim, ku secili nga aktorët mbron pozicionin përkatës të grupit të tij/saj. Pjesa tjetër e nxënësve janë juria ose komiteti i cili do të votojë mbi vendimin që duhet marrë pas prezantimeve.

Në mënyrë që nxënësit të kuptojnë procesin e përgatitjes së dramës, mund të ndërmerren hapat e mëposhtme:

- ✓ Përcaktoni natyrën e sfidës së ruajtjes me të cilën përballet monumenti i Trashëgimisë Botërore. Kjo mund të jetë: kërkesa për rrënim, për të ndërtuar një ndërtesë të re, lufta, ndikimet atmosferike etj;
- ✓ Nxënësit që përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi prezantojnë mënyra të mundshme për t'u përballur me këtë sfidë;
- ✓ Nxënësit vlerësojnë zgjidhjet e prezantuara;
- ✓ Nxënësit zgjedhin zgjidhjen më të mirë në mënyrë demokratike;
- ✓ Nxënësit vendosin si të implementojnë zgjidhjen;
- ✓ Nxënësit vlerësojnë pasojat e zgjedhjes së tyre.

⁴³ Pateraki Irene & Santi Scimeca ed., *Të mësuarit nga e kaluara, projektimi i të ardhmes sonë: trashëgimia kulturore e Evropës nëpërmjet eTwinning*, Berlin, 2018, faqe 45, https://www.etwinning.net/eun-files/eTwinning%20book_SQ.pdf, qasur Qershor 2020.

⁴⁴ UNESCO "Trashëgimia Botërore në duart e të rinjëve", Paris, 2015, faqe 29-30, <https://whc.unesco.org/en/educationkit/#downloadkit>, qasur Qershor 2020.

9. Aktivizmi dhe pjesëmarrja aktive në aktivitete të lira dhe shoqata

Shoqata të ndryshme dhe Organizata Joqeveritare të cilët veprojnë në territorin e Kosovës, organizojnë iniciativa dhe projekte të ndryshme në fushat e ndryshme, që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave të njeriut, proceset gjithëpërfshirëse në planifikim, ngritjen e vetëdijes së komunitetit për një përfshirje aktive në organizimin e jetës publike, mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore etj.

OJQ EC Ma Ndryshe gjatë vitit 2019 ka organizuar projektin me titull Aktrural – Aktivizmi i të rinjve në zonat rurale të Kosovës. Synimi kryesor i këtij projekti, ka qenë rritja e mundësisë së angazhimit të rinjve në nisma të aktivizmit, vullnetarizmit dhe aktivitete jashtëkurrikulare, që do të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes rreth rolit të përfshirjes aktive në komunitet.⁴⁵ Në këtë projekt janë përfshirë institucionet e nivelit lokal, shkollat e mesme të larta, këshillat e fshatrave, grupet e organizuara të komunitetit dhe mediat lokale.

Nëpërmjet aftësimit të të rinjve për t'i shndërruar në qytetarë aktiv, është prezantuar rëndësia e qytetarisë aktive dhe mënyrat se si përmes vullnetarizmit mund të kontribuojnë në komunitetin ku ata jetojnë.

Si rezultat i këtij projekti, mbi 150 të rinj dhe të reja janë aftësuar, duke u bërë bartës dhe pjesëmarrës në nisma të aktivizmit në nivel të komunitetit. Nëpërmjet aktivizmit të rinjtë kanë adresuar çështje të ndjeshme shoqërore dhe kulturore, përfshi barazinë gjinore dhe bashkëjetesën.

Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar 88 iniciativa, të cilat janë implementuar bashkë me të rinjtë pjesëmarrës dhe palët bashkëpunuese nga tërë rajonet e Kosovës. Këto iniciativa kanë qenë të natyrave të ndryshme, ndërhyrje direkte me qëllim të përmirësimit të hapësirave publike në shkolla, lagje; kërkesa zyrtare, peticione, trajnime, kampanja vetëdijesuese dhe aktivitete kulturore.

Pjesëmarës në këtë projekt kanë qenë edhe fshatrat e Komunës së Istogut. Si rezultat në këtë komunë janë realizuar pesë iniciativa:

- Kërkesë dhe peticion për vendosjen e ndriçimit publik në fshatin Tomoc;
- Aktiviteti "Zebra shumëngjyrëshe" në fshatin Dubravë;
- Rregullimi i hapësirës në shtëpinë e të moshuarve në fshatin Gurrakoc;
- Aktiviteti "Zebra shumëngjyrëshe" në fshatin Vrellë;
- Murale artistike në shkollën fillore "Martin Camaj" në fshatin Gurrakoc;

⁴⁵ Ec Ma Ndryshe, Punëtorja përmbyllëse e projektit "Aktrural", <https://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,706#.Xq7Jx6gzaM9>, qasur Qershor 2020.




FIGURA 10 PAMJE NGA AKTIVITETI "ZEBRA SHUMËNGJYRËSHE" (BURIMI: EC MA NDRYSHE)

9.1. Aktivizmi dhe puna vullnetare në shkollat e Komunës së Istogut

Nëpërmjet edukimit rreth aktivizmit, punës vullnetare, të rinjtë edukohen të bëhen pjesëmarrës aktiv në komunitet, dhe në shoqërinë ku jetojnë. Në këtë mënyrë ata vetëdijesohen për të drejtat e tyre, për të kërkuar një ambient më të sigurtë dhe më kualitativ jetësor.

Aktivizmi si proces, i shoqëruar me edukim dhe vetëdijesim për vlerat dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, kontribuon në krijimin e gjeneratave të reja, të cilët do të luajnë rolin kryesor në jetën publike e shoqërore në të ardhmen.

Pjesëmarrësit në aktivitetet e organizuara në kuadër të projektit Akt Rural, duke u nisur nga përvoja e fituar, mund të fillojnë me organizimin e aktiviteteve të ngjashme në shkollat e tyre, dhe në shkollat tjera të Komunës së Istogut.

Edukimi rreth rëndësisë së përfshirjes aktive dhe kontributit në komunitet, përmes punës vullnetare, duhet të luajë një rol thelbësor, në edukimin e përgjithshëm të nxënësve, duke filluar që nga moshat e hershme.

Ngjashëm me aktivitetet dhe iniciativat e realizuara në projektin e lartpërmendur, mund të organizohen iniciativa që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe të monumenteve të trashëgimisë kulturore.

Një aksion i pastrimit të oborrit të shkollës, oborrit të xhamisë apo mullirit të vjetër në fshat, do të kontribuonte në ngritjen e vetëdijesimit të nxënësve, rreth rolit dhe kontributit të tyre për të krijuar një mjedis më kualitativ jetësor. Përfshirja e prindërve, dhe përfaqësuesve të komunitetit, krahahs nxënësve dhe mësimeve, do të ngriste ndikimin e iniciativave të tilla.

Në këto iniciativa, krahas mësimeve nga fusha Shoqëria dhe Mjedi, rekomandohet të marrin pjesë edhe mësime nga fusha e Arteve dhe Edukatës fizike. Aktiviteti i organizuar në terren, më pas mund të shoqërohet me punime dhe detyra nga këto fusha.

10. Festimet në data të veçanta – Shënimi i datave të rëndësishme

Në fushën e trashëgimisë kulturore shënohen disa data të veçanta, që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijesimit të publikut në rolin e vlerave të trashëgimisë kulturore në jetën shoqërore. Këto data janë të përcaktuara ndërkombëtarisht, dhe shënohen nëpërmjet një sërë aktiviteteve të ndryshme.

Nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta, krahas edukimit në përputhje me kurrikulën shkollore, duhet të njoftohen me këto data të rëndësishme.

Institucionet e Kosovës, respektivisht institucionet vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjithashtu shënojnë këto data të rëndësishme, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme nga fusha e trashëgimisë kulturore.

Aktivitetet e paraqitura në kapitujt e mësipërm, mund të organizohen për të shënuar njërën nga këto ditë të rëndësishme për edukimin dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë së përbashkët kulturore.

Në vijim paraqitet nga një përshkrim i përgjithshëm i datave më rëndësi.

Ditët e Trashëgimisë Europiane (Shator) paraqesin një iniciativë të përbashkët të Këshillit të Europës dhe Komisionit Europian, që përfshin 50 shtetet pjesëmarrëse në Konventën Kulturore të Europës, nën moton e përbashkët: Europa, një trashëgimi e përbashkët. Çdo vit, gjatë muajit shtator, organizohen aktivitete dhe ngjarje për të shënuar Ditët e Trashëgimisë Europiane. Programi vjetor përmban mundësi për të vizituar monumente të cilët kryesisht janë të mbyllura për publikun. Këto aktivitete kanë për qëllim të zgjerojnë qasjen dhe të inkurajojnë kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore dhe asaj natyrore. Këto ngjarje njihen edhe me emërtimin Ditët e Dyerve të Hapura. Për edicionin e vitit 2020, tema e caktuar për Ditët e Trashëgimisë Europiane është: Festojmë Trashëgiminë dhe Edukimin!⁴⁶

Dita Ndërkombëtare e Monumenteve (18 Prill) – Ndryshe e quajtur edhe si Dita e Trashëgimisë Botërore është një ceremoni ndërkombëtare e cila shënohet çdo vit nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, ku përfshihen vizita në lokalitete të trashëgimisë kulturore, konferenca, punëtori dhe prezantime në artikuj në media të shkruara dhe elektronike. Dita Ndërkombëtare e Monumenteve është propozuar nga Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve dhe Lokaliteteve (ICOMOS), dhe është aprovuar nga asambleja gjenerale e UNESCO-s. Qëllimi i kësaj dite është promovimi dhe vetëdijesimi rreth diversitetit të trashëgimisë kulturore të njerëzimit, cënueshmëria e tyre dhe përpjekjet e nevojshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre. Çdo vit tema e shënimit të kësaj dite caktohet nga këshilli organizativ. Për vitin 2020 tema e propozuar ka qenë: Kulturat e përbashkëta, Trashëgimia e përbashkët, Përgjegjësia e

⁴⁶ Këshilli i Europës, Ditët e trashëgimisë Europiane, <https://www.europeanheritagedays.com/Shared-Theme/>, qasur Qershor 2020.

përbashkët – si një shprehje e unitetit global përballë krizës shëndetësore në vazhdim në mbarë botën.⁴⁷

Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve (18 Maj) – paraqet një datë ndërkombëtare e cila koordinohet nga Këshilli Ndërkombëtar i Muzeumeve (ICOM). Kjo datë thekson një temë të veçantë çdo vit, që reflekton bazën e preokupimeve të komunitetit ndërkombëtar muzeumeve. Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve shërben si një platformë për ngritje të vetëdijes publike rreth rolit të muzeumeve në zhvillimin e shoqërisë, në nivel ndërkombëtar. Tema për vitin 2020 është propozuar: Muzeumet për Barazi: Diversiteti dhe Gjithpërfshirja.⁴⁸



FIGURA 11 VIZITAT E NXËNËSVE NË MUZEUN KOMBËTAR TË KOSOVËS (BURIMI: MUZEU KOMBËTAR I KOSOVËS)

Ditët Europiane të Arkeologjisë (19-21 Qershor) – kjo iniciativë daton nga viti 2010, dhe ka për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe promovimin e audiencave të gjera rreth arkeologjisë. Një spektër i gjërë i aktiviteteve festive organizohen, me qëllim që të mundësojnë familjarët, nxënësit, studentët dhe entuziastët të zbulojnë trashëgiminë arkeologjike. Disa nga aktivitete të ndryshme që organizohen për shënimin e kësaj date: Organizohen vizita, në vende ku zakonisht nuk ka qasje publike (Lokalitete ku gërmohen, qendra të hulumtimeve, koleksione arkeologjike etj), takime me profesionistët në fushën e arkeologjisë, të cilët e prezantojnë punën e tyre para publikut, si dhe aktivitete edukuese dhe argëtuese për pjesëmarrësit. Tema për vitin 2020 është përcaktuar: Historia juaj.⁴⁹

⁴⁷ ICOMOS, Kulturat e përbashkëta, Trashëgimia e përbashkët, Përgjegjësia e përbashkët, <https://www.icomos.org/en/focus/18-april-international-day-for-monuments-and-sites>, qasur Qershor 2020.

⁴⁸ ICOM, Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve, <http://umac.icom.museum/international-museum-day-2020/>, qasur Qershor 2020.

⁴⁹ Ditët e Arkeologjisë Europiane, <https://journees-archeologie.fr/c-2020/lg-en/serbia/presentation>, qasur Qershor 2020.

IV. Konkluzionet dhe Rekomandimet

Ashtu si u elaborua edhe në kapitujt paraprak, fusha e trashëgimisë kulturore sot gjendet para sfidave dhe kërcënimeve të shumta, duke filluar nga faktorët natyrorë, ndryshimet shoqëro-ekonomike, konfliktet e armatosura, fatkeqësitë natyrore, madje edhe mungesa e njohjes dhe vlerësimit të saj për mirëqenien dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive dhe komuniteteve. Në mënyrë që të sigurohen veprime konkrete në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, është me rëndësi të madhe mobilizimi i një spektri të gjerë të palëve të interesit. Një palë e rëndësishme e interesit e cila duhet të përfshihet, janë fëmijët dhe të rinjtë, të cilët do të luajnë një rol kyç në jetëgjatësinë dhe transmetimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në gjeneratat e ardhshme. Ashtu si elaborohet edhe në konventa ndërkombëtare të UNESCO-s dhe organizatave europiane, vetëm ngritja e vetëdijes, ndërgjegjësimi dhe promovimi i vlerave nuk është i mjaftueshëm. Përfshirja aktive në të drejtën për të pasur qasje dhe për të përjetuar trashëgiminë kulturore në të gjitha aspektet e politikave publike dhe qasjes gjithëpërfshirëse, është kyçe.

Mungesa e vetëdijes rreth vlerave të trashëgimisë kulturore dhe mungesa e përfshirjes aktive në mbrojtjen e saj nga palët e interesit, do të ndikojë në rrezikimin e humbjes së saj, dhe njëkohësisht do të zbeh ndjenjën e përkatësisë dhe identitetit të gjeneratave të reja. Në këtë drejtim edukimi ka rol shumë të rëndësishëm.

Zhvillimi i një programi gjithëpërfshirës për edukim rreth trashëgimisë kulturore, propozohet me qëllim të përforsimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në të gjitha format e saj, duke mundësuar qasjen dhe përjetimin e saj nga gjeneratat e reja, duke zhvilluar identitetin dhe kontribuar në rezultate të përmirësuara të të nxënësve.

Organizatat ndërkombëtare që merren me fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, sikurse UNESCO⁵⁰, kanë zhvilluar programe të shumta në drejtim të Edukimit të Trashëgimisë Kulturore. Këto programe përfshijnë materiale informative dhe didaktike për mësimdhënës dhe nxënës, dhe pilot projekte të shumta të zhvilluara në vende të ndryshme. Disa nga këto materiale janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe janë të qasshme nëpërmjet ueb faqes së UNESCO-s. Mungesa e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare sikurse UNESCO, Këshilli i Europës, paraqet një dobësi, ngase nuk mund të përfitojë drejtpërdrejtë nga këto programe.

Në nivel kombëtar, është e rëndësishme të theksohet nevoja imediate për zhvillimin e një iniciative edukative, që do të integrojë kulturën dhe trashëgiminë kulturore në kurrikulë mësimore.

Përkundër nismave të ndryshme gjatë viteve, integrimi i temës së trashëgimisë kulturore në proces mësimor mbetet sfida për institucionet edukative.

⁵⁰ UNESCO, Mësimi përmes trashëgimisë: rritja e përfshirjes së të rinjve, <https://en.unesco.org/system/files/Learning%20through%20heritage%20-%20Enhancing%20youth%20engagement.pdf>, qasur Qershor 2020.

Në vitin 2015, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka miratuar doracakun për trashëgiminë dhe diversitet kulturor, si një mjet ekstra-kurikular në lënden "Shoqëria dhe natyra" (klasa 3 deri 9). Duke u bazuar në një përcjellje jo formale të punës së 24 mësuesve që fillimisht kanë qenë të involvuar në projekt, është parë që vetëm 6 prej tyre vazhdojnë ta përdorin si metodë opcionale (joobligative) doracakun në mësimin që ata e zhvillojnë.⁵¹

Një bashkëpunim i mirëfilltë ndërmjet Minsitrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është i domosdoshëm, në mënyrë që të ndërmerren hapat konkrete drejt zbatimit të synimeve dhe objektivave të përbashkëta për të krijuar një brez të edukuar dhe të aftësuar me shkathtësitë dhe vlerat në harmoni me kërkesat e shoqërisë demokratike. Dhe njëkohësisht për të zbatuar njërin nga objektivat e Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturor, që ka të bëjë me edukimin e gjeneratave të reja në fushën e trashëgimisë kulturore.

Rekomandimet

Në mënyrë që ky Udhëzues të jetë i zbatueshëm, në vijim paraqiten rekomandimet për hapat e më tutjeshme:

1. **Konsultimi, finalizimi dhe aprovimi i Udhëzuesit:** "Udhëzues për integrimin e të mësuarit praktik të trashëgimisë kulturore në kurrikulën mësimore" nga ana e Komunës së Istogut mund të aprovohet si dokument strategjik në kuadër të programit të Drejtorisë Komunale për Arsim, dhe në këtë mënyrë të jetë i obligueshëm zbatimi i tij nga ana e shkollave të kësaj komune.
2. **Themelimi i komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzuesit** - i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzuesit nga ana e shkollave të Komunës së Istogut.
3. **Trajnim i mësimeve** - Faza fillestare për zbatim të udhëzuesit përfshin krijimin e kapaciteteve të mësimeve, në mënyrë që të njoftohen me konceptin e trashëgimisë kulturore dhe integrimin e këtij koncepti në proces mësimor. Nga çdo shkollë mund të përzgjedhen nga dy mësime, përfshirë edhe drejtorin apo zv.drejtorin e shkollës, të cilët do të marrin pjesë në trajnime. Këta mësime më pas do të jenë përgjegjës për trajnim të kolegëve të tyre, dhe do të luajnë rolin e koordinatorit ndërmjet Komisionit për Mbikëqyrje dhe shkollës.
4. **Themelimi i një sektori të veçantë në Bibliotekë për fushën e Trashëgimisë Kulturore** - Në kuadër të Bibliotekës Komunale, mund të iniciohet themelimi i një sektori të veçantë për fushën e trashëgimisë kulturore. Ky sektor do të shërbejë fillimisht për mësime, e më pas edhe për nxënësit. Në Kosovë janë botuar një numër i konsiderueshëm i botimeve nga fusha e trashëgimisë kulturore. Këto botime, pasuruar edhe me botimet

⁵¹ Arif Muharremi, Edukimi në Planin e Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit, faqe 191, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40669>, qasur Qershor 2020.

ndërkombëtare në gjuhën angleze, ofrojnë një burim të rëndësishëm për integrimin e trashëgimisë kulturore në kurrikulën mësimore.

5. **Ngritja e kapaciteteve logjistike dhe infrastrukturore e shkollave** – me qëllim të zbatimit të aktiviteteve të paraqitura në këtë udhëzues, është e nevojshme që shkollat të pajisen me pajisje relevante, sikurse projektorë, laptop, materiale të punës (për përgatitje të ekspozitave), dhe buxhet vjetor shtesë për realizim të vizitave studimore gjatë vitit.
6. **Zbatimi i aktiviteteve të udhëzuesit.** Shkollat e Komunës së Istogut mund të përzgjedhin nga lista e gjatë e shembujve dhe të testojnë aktivitetet e propozuara nga ky Udhëzues. Komisioni përkatës mund të bëjë evaluimin e tyre dhe të propozojë ndryshime apo sygjryme shtesë pasi të mirret një raport gjithëpërfshirës nga shkollat që kanë zbatuar aktivitetet e tyre.

V. Lista e librave që rekomandohen për lexim

- ✓ **Trashëgimia Botërore në duart e të rinjve – Doracak edukativ**, UNESCO, 1998, <https://whc.unesco.org/en/educationkit/>.
- ✓ **Të mësuarit nga e kaluara, projektimi i së ardhmes sonë**, Bashkimi European dhe E-twinning, 2018, https://www.etwinning.net/eun-files/eTwinning%20book_SQ.pdf.
- ✓ **Hyrje në Trashëgiminë Kulturore – Doracak për vetëdijesimin e të rinjëve mbi vlerat e trashëgimisë kulturore**, Rexhep Ahmetaj, QRTK Prizren, 2019.
- ✓ **Guida Arkeologjike e Kosovës**, Milot Berisha, Instituti Arkeologjik i Kosovës, 2012.
- ✓ **Plani Regjional i Trashëgimisë** – Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë, Këshilli i Europës, 2015, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806af033>.
- ✓ **Udhëzues: Program i trajnimit: Mësimi i trashëgimisë kulturore dhe diversitetit kulturore**, Jenny Otting dhe Veton Sylhasi, Këshilli i Europës, 2013, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae6af>.
- ✓ **Doracak për mësimdhënës – Njësi mësimore për trashëgiminë kulturore dhe diversitetin kulturor**, Këshilli i Europës, 2012, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae5c8>.
- ✓ **Çka është Trashëgimia – një koncept jashtëtokësor**, Këshilli i Europës, 2012, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae4d0>.
- ✓ **Tregimet e gjyshërve tanë**, Këshilli i Europës, 2012, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae5c3>.

- ✓ **Iniciativa e Itinerarit Kulturor**, Këshilli i Europës, 2012,
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ae4d2>.
- ✓ **E ka kush e ka?**, CHwB Albania,
<http://chwb.org/albania/activities/koleksioni-per-femije-e-ka-kush-e-ka/?lang=sq>.
- ✓ **Trashëgimia Kulturore Vushttri**, CHwB Kosova, 2014,
<http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2015/11/Trashegimia-Kulturore-Vushttri.pdf>

Aneks 1 – Fleta e Aktiviteteve për Nxënësit (UNESCO)

Hulumtimi për një objekt në muze			
Tregoni objektin e muzeumit që do të studioni:			
Aspektet që do të vëzhgohen	Pyetje	Vëzhgime	Pyetje të tjera të nevojshme
Tipare Fizike	Çfarë ngjyrë është? Çfarë arome ka objekti? Si tingëllon? Nga çfarë materiali përbëhet? Është natyral apo i bërë nga njeriu? Është i plotë? Është ndryshuar, përshtatur apo rregulluar? Është i vjetëruar?		
Ndërtimi	Është i bërë me dorë apo me makineri? Është bërë me kallëp apo në pjesë? Si është bashkuar?		
Funksioni	Si është përdorur objekti? Ka ndryshuar përdorim?		
Projektimi	A e përmbush mirë detyrën që i është caktuar si objekt? Është i dekoruar? A janë përdorur materialet më të mira? A ju pëlqen pamja e objektit? Si do ta dizajnonit ju?		
Vlera	Sa është vlera e tij? Për njerëzit që e bënë? Për njerëzit që e përdorën? Për njerëzit që e mbajnë? Për ju? Për një muze?		

Aneks 2 – Fleta e Aktiviteteve për Nxënësit (UNESCO)

Vizitë në lokalitetin e Trashëgimisë Kulturore

Të plotësohet nga çdo nxënës para, gjatë dhe pas një vizite në një lokalitet të trashëgimisë kulturore

Emri i lokalitetit

.....

Emri i nxënësit

.....

Data e Vizitës

.....

Shkruani pritshmëritë tuaja për vizitën (çfarë do të donit të zbulonit, për çfarë do të donit të mësonit?)

Gjatë Vizitës

Bëni një vizatim të një karakteristike ose një pjesë të lokalitetit që ju pëlqen më shumë (përdorni një fletë të veçantë).

Regjistroni disa fakte dhe shifra që mësuat për lokalitetin:

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Raportoni mbi zbulimet ndijore: kur i mbyllni sytë, përshkruani çfarë dëgjoni, çfarë arome ndjeni dhe përshkruani aspektin e lokalitetit që ju bën më shumë përshtypje:

Zhurma:

.....

.....

Aroma:

.....

.....

Pamja:

.....

.....

Pas vizitës

A ishte vizita në lartësinë e pritshmërive tuaja?
Jo

Po

Shpjegoni

Pse mendoni që ky lokalitet është i rëndësishëm?

Komentet e fundit

Emri dhe Mbiemri i nxënësit

Data:

Për EC Ma Ndryshe

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar ne vitin 2006, që angazhohet për avancimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse.

EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mire (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes).

EC angazhohet për qytete/komuna gjithëpërfshirëse në Kosovë. Organizata beson në vlerën e shtuar që sjell angazhimi i gjithësecilit në qeverisjen e qyteteve/komunave dhe në veçanti e atyre që kanë më pak qasje dhe mundësi për të ndikuar.

Në punën e saj 13 vjeçare EC është fokusuar në mobilizimin e komunitetit duke u dhënë prioritet grupeve të nën përfaqësuar. Ky angazhim e ka vendosur EC-in në krye të organizatave të komunitetit në Kosovë. Një nga metodologjitë dalluese të EC-it është ajo e planifikimit urban me pjesëmarrje, rezultatet e së cilës janë tejet të prekshme në komunën e Prizrenit. Për shumë qytetarë të Prizrenit, por edhe për disa lokacione të tjera në Kosovë, EC shihet si adresë shumë kredibile për çuarjen tutje të nevojave, kërkesave dhe interesave komunitare. EC ka punuar dhe vazhdon të punoj ngushtë me PAK, të moshuarit, gratë dhe vajzat, banorët e lagjeve informale, komunitetet jo shumicë, artistët, ambientalistët dhe shumë të tjerë në baza ditore në përpjekjen e përbashkët për t'i kthyer nevojat e qytetarëve në vendime e veprime të institucioneve. Në të njëjtën kohë, EC ka ndërtuar grupe lokale të komunitetit në nivel të lagjes dhe fshatit në komunën e Prizrenit, ndërsa nga viti 2018 këtë praktikë po e bart edhe në komunat e tjera të Kosovës.

Përveç angazhimit komunitar, EC njihet edhe për avokimin konsistent në mbrojtje të strukturës urbane të qyteteve të Kosovës, me fokus në vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Përmes rrjetit të gjerë të profesionistëve me të cilët bashkëpunon në baza të rregullta, EC ka zhvilluar standard të larta të cilësisë sa i përket shërbimeve që i ofron dhe produkteve që i realizon.

Organizata ka qenë dhe vazhdon të jetë kontribuese e drejtpërdrejtë e hartimit të një numri të konsiderueshëm politikash publike në nivel qendror dhe lokal.

Në të njëjtën kohë, EC ka prezencë të shtuar edhe rajonale dhe ndërkombëtare përmes mekanizmave të rëndësishëm të rrjetëzimit profesional dhe të shoqërisë civile.

Qershor 2020

